

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7164
E martë, 16 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Maqedonia e Veriut
mbështet hyrjen
e Kosovës në KiE | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PAFUQIA E MARRËVESHJES SË OHRIT PËR ANËTARËSIM NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

FAQE 4-5



Në Nenin 4 të Marrëveshjes së Ohrit thuhet qartë se Serbia "nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare". Por, Serbia ka

ngritur një grup punues për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Analistët nuk presin ndonjë lëvizje të madhe në procesin për normalizimin e

marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë në kohën kur kanë mbetur edhe pak muaj deri te zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe për disa pozita kyçe në BE

CLINTONI THOTË SE KOSOVA KA ARRITUR PËRPARIM TË RËNDËSISHËM DREJT BARAZISË GJINORE

F. 3

LAJÇAKU PRET NGA BISLIMI DHE PETKOVIQI TË JENË 'MENDJEHAPUR' NË TAKIMIN QË ZHVILLOHET NË FUND TË JAVËS

F. 5

AKTUALE



ÇFARË PRITET TË NDODHË PAS EKSPOZIMIT TË LUFTËS NË HIJE IRAN - IZRAEL?

F. 2


KONJUFCA DHE KURTI NDEROJNË TË RËNËT NË SLLOVI TË LIPJANIT

F. 6

ASK-JA: DERI MË TANI JANË REGJISTRUAR MBI 200 MIJË QYTETARË, KA INTERESIM EDHE NGA SERBËT

F. 7

EKONOMI



AKTAKUZË KUNDËR KATËR ZYRTARËVE TË NDËRMARRJES "TREPÇA"

F. 8

NJË DELEGACION I BQK-së PO MERR PJESË NË TAKIMET PRANVERORE TË FMN-së DHE TË BB-së NË UASHINGTON

F. 8

SPORT



SONTE MËSOHEN DY GJYSMËFINALISTET E PARË NË LIGËN E KAMPIONËVE

F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria evakuon 15 persona nga Izraeli, tre prej tyre nga Kosova

TIRANË, 15 PRILL - Pesëmbëdhjetë shtetas shqiptarë, mes të cilëve tre nxënës nga Kosova që ndodheshin në Izrael në kohën kur Irani kreu sulm ndaj Izraelit, pritet të kthehen mbrëmjen e së hënës.

Mbrëmjen mes 13 dhe 14 prillit Irani sulmoi Izraelin me dronë dhe raketa, në shenjë hakmarrjeje për një sulm vdekjeprurës në konsullatën e tij në Siri, më 1 prill. Ministria e Jashtme e Shqipërisë bëri me dije se 15 qytetarët janë larguar nga Tel Avivi ditën e diel dhe ndodhen në Qipro. Fluturimet e tyre drejt Shqipërisë u anuluan mëngjesin e së dielës për shkak të situatës së tensionuar në rajon.

Ndërkaq, nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës nuk ka ndonjë reagim zyrtar për evakuimin e tre kosovarëve. Megjithatë, një ditë më herët kjo ministri publikoi një numër të Ambasadës së Kosovës në Izrael për të gjithë shtetasit e Kosovës në këtë shtet që mund të kenë nevojë për ndihmë pas

sulmit të Iranit. Ndërkaq, Ministria e Jashtme e Shqipërisë tha se pesë nga të evokuarit janë punonjës të Ministrisë së Turizmit të Shqipërisë dhe familjarë të tyre. Ata gjendeshin në Izrael me ftesë të ambasadores shqiptare Meri Kumbe dhe autoriteteve izraelite për të marrë pjesë në aktivitetin turistik "Allbania all senses", ku ishin të pranishëm edhe operatorë turistikë izraelitë. "Prej mbrëmjes të së shtunës, përmes koordinimit të pandërprerë me ambasadat e Shqipërisë në Izrael dhe Egjipt, nisëm punën për ta organizuar kthimin e të gjithë qytetarëve shqiptarë, fluturimet e të cilëve u anuluan për shkak të situatës së tensionuar në rajon", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Jashtme shqiptare.

Në Qipro ndodhen edhe dhjetë nxënës që studiojnë në shkollat ndërkombëtare në Izrael, shtatë prej të cilëve nga Shqipëria dhe tre nga Kosova. "Sot në mbrëmje të 15 qytetarët që u larguan nga Tel Avivi udhëtojnë drejt Tiranës e



Prishtinës. Po punohet për kthimin në atdhe edhe të dy qytetarëve, të cilët nuk mundën dot të përgjigjeshin në telefon të dielën derisa përgatitej fluturimi i radhës", tha ministria shqiptare. Bëhet me dije se 13 turistë shqiptarë janë larguar mbrëmjen e

14 prillit nga Jordania, e prej disa orësh janë pranë familjeve të tyre në atdhe.

Izraeli që nga 7 tetori po zhvillon luftë në Gazë kundër Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian

- pasi grupi radikal kreu sulm vdekjeprurës në jug të Izraelit. Ambasadorja e Shqipërisë, Meri Kumbe, ka deklaruar për mediet në Shqipëri se prej muajit tetor të vitit 2023, kur nisi lufta në Gazë, janë evakuuar 330 persona nga Izraeli drejt Shqipërisë.

Çfarë pritet të ndodhë pas ekspozimit të luftës në hije Iran - Izrael?

TEHRAN, 15 PRILL - Sulmi i paprecedent i Iranit ndaj Izraelit mes së shtunës dhe së dielës shënoi ndryshim në qasje për Teheranin, i cili ishte varur nga bashkëpunëtorët në mbarë Lindjen e Mesme që nga nisja e luftës mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në tetor. Të gjithë sytë tani janë të përqendruar në atë nëse Izraeli do të zgjedhë të ndërmarrë veprim të mëtejshëm ushtarak përderisa Uashingtoni po synon të përdorë masa diplomatike për t'i ulur tensionet rajonale.

Irani tha se sulmi ishte në përgjigje të një sulmi ajror për të cilin gjerësisht ka fajësuar Izraelin, sulm që shkatërroi ato që Irani tha se ishin zyra konsullore të tij në Siri dhe vrau dy gjeneralë të Gardës Revolucionare më herët gjatë këtij muaji.

Izraeli tha se pothuajse të mbi 300 dronët dhe raketat e lëshuara nga Irani u rëzuan nga sistemet e tij të mbrojtjes ajrore, me mbështetjen e ShBA-së dhe Britanisë. Si pasojë e sulmeve u raportua se një vajzë u plagos në jug të Izraelit si dhe u raportua për dëme të vogla në një bazë ajrore izraelite që u godit nga një raketë.

Megjithatë, shefi i Gardës Revolucionare të Iranit e quajti të suksesshëm operacionin.

Irani ka arritur të krijojë një balancë mes hakmarrjes publike për sulmin në Damask dhe ta shmangë provokimin e mëtejshëm të veprimt



ushtarak izraelit, të paktën fillimisht, një veprim që do të mund të çonte në një konflikt më të gjerë, tha Mona Yacoubian, zëvendës-presidente e qendrës për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut në Institutin amerikan të Paqes. "Të dy [Irani dhe Izraeli] në këtë pikë janë në gjendje të shpallin fitore dhe të largohen nga gremina, veçmas për faktin se nuk ka civilë izraelitë të vrarë", tha Yacoubian.

Megjithatë, bota po priste rezultatin e takimit të Kabinetit të Luftës të Izraelit të dielën. Izraelitët e linjës së ashpër kanë kërkuar të ketë përgjigje, por të tjerët kanë kërkuar përmbajtje, duke argumentuar se Izraeli duhet të përqendrohet në forcimin e lidhjeve me partnerët

arabë. "Ne do të krijojmë një koalicion rajonal që Irani ta paguajë çmimin në mënyrën dhe kohën që ne e zgjedhim", tha Benny Gantz, anëtar i Kabinetit të Luftës.

Analistët thanë se Irani dërgoi mesazhin se ka vullnet ta përshkallëzojë situatën dhe ndryshoi rregullat e tij në luftën në hije që zhvillon me Izraelin. "Këto ishin të shtëna paralajmëruese, përmes të cilave u tha se nëse Izraeli thyen rregullat, ka pasoja", tha Mangus Ranstorp, këshilltar strategjik në Universitetin suedez të Mbrojtjes.

Sulmi i Iranit ka rritur edhe më shumë frikën se lufta në Gazë mund të shkaktojë kërdi rajonale. Por, Irani tha se nuk po kërkon një luftë në

shkallë të plotë në mbarë rajonin. Ministri i Jashtëm, Hossein Amirabdollahian, shkroi në X, se Irani në këtë pikë "nuk ka qëllim t'i vazhdojë operacionet mbrojtëse", përveç nëse sulmohet.

Irani theksoi se ka sulmuar ndërtesat izraelite që ishin të përfshira në sulmin në Damask, dhe jo "zona ekonomike" apo civile. Pasi Izraeli nisi ofensivën e tij në Gazë kundër Hamasit, grupet e mbështetura nga Irani u përfshin ushtarakisht, ndërkaq Teherani qëndroi anash. Grupi Hezbollah në Liban sulmoi me raketa veriun e Izraelit. Rebelët jemenas Huthi sulmuar anijet perëndimore në Detin e Kuq. Një grup ombrellë i milicive irakiane të mbështetura

nga Irani sulmuar pozicionet ushtarake amerikane në Irak dhe Siri.

Tani Teherani "është i gatshëm ta rritë çmimin" pa u varur në bashkëpunëtorët e tij, tha drejtoresha e Qendrës Carnegie për Lindjen e Mesme, Maha Yahya.

Deri më tani Irani ka vepruar vetëm kaq. "Ata kanë lëshuar paralajmërime të mjaftueshme që tregonin se ajo po vinte dhe mendoj se ata e dinin që [dronët dhe raketat] do të rrëzoheshin para se ta arrinin territorin izraelit", tha Yahya.

Ajo, po ashtu, tha se presioni në rritje ndaj Izraelit për shkak të sjelljes së tij në Gazë tani është zhvendosur në shtensionimin e tensioneve rajonale.

Yacoubian tha se Uashingtoni ka një rol të rëndësishëm që të luajë në shmangien e përshkallëzimit të mëtejshëm.

Ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme ushtarake nga Izraeli nuk duket një vendim që është popullor në mesin e aleatëve, përfshirë ShBA-në, tha Eldad Shavit, i cili udhëheq Programin Kërkimor Izrael - ShBA, që funksionon në kuadër të Institutit Kombëtar për Studime të Sigurisë.

Zëdhënësi i sigurisë kombëtare të Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, i tha NBC-së se presidenti Joe Biden nuk dëshiron një përshkallëzim në konfliktin rajonal apo një "luftë të gjerë" me Iranin dhe "personalisht po punon në aspektin diplomatik për këtë çështje". (Associated Press / REL)

Clintoni thotë se Kosova ka arritur përparim të rëndësishëm drejt barazisë gjinore

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, tha të hënën se Kosova ka shënuar "përparim të rëndësishëm" drejt arritjes së "barazisë gjinore në sektorin publik dhe në politikë".

Clintoni iu adresua përmes një videoje Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, që po zhvillohet edicionin e dytë në Prishtinë.

Ndër sukseset e Kosovës në fushën e të drejtave të grave, Clintoni përmendi reparacionet për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, duke theksuar se "jeni përkushtuar në ruajtjen dhe forcimin e paqes, në zgjerimin e mundësive ekonomike dhe dëshmuat se bashkëpunimi sjell më shumë përfitime sesa konflikti". "Paqja nuk ka qenë gjithmonë e lehtë, veçmas tani kur tensionet në rajonin e Ballkanit edhe një herë po përshkallëzohen, teksa lufta e paprovokuar e Rusisë kundër Ukrainës vazhdon dhe forcat antidemokratike në botë

nxisin përçarje dhe urrejtje. Prandaj, forume të tilla janë të rëndësishme. Gratë nuk janë vetëm viktima të dhunës dhe pabarazisë. Gratë janë promovuese të paqes dhe përparimit", tha Clinton. Edicioni i dytë i forumit përqendrohet në temën e dhunës seksuale gjatë konflikteve dhe në sigurinë klimatike.

Clinton tha se ky forum është i rëndësishëm, pasi shfaq vendosmërinë për t'i amplifikuar zërat e grave dhe për ta forcuar pjesëmarrjen e grave në të gjitha sferat e jetës dhe "për të siguruar një balancë gjinore në vendimmarrjen për paqe dhe siguri në Kosovë dhe në mbarë botën".

Ajo tha se po punon me Departamentin Amerikan të Shtetit dhe Institutin Georgetown për krijimin e një qendre rajonale të ekselencës për gratë, paqen dhe sigurinë, që do ta ketë selinë në Kosovë. "Demokracitë tonë janë më të forta dhe më të qëndrueshme kur gratë janë të përfshira dhe trajtohen të

barabarta dhe veçmas kur gratë udhëheqin", tha Clinton në adresimin e saj.

Forumit dyditor, që zhvillohet me përkujdesjen e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbledhur përfaqësues nga më shumë se 40 shtete në mbarë botën.

Osmani gjatë hapjes së punimeve të forumit tha se në kohën kur në botë po zhvillohen disa konflikte, përfshirë atë në Gazë dhe Ukrainë, "agjenda për siguri dhe paqe të grave është më e rëndësishme se kurrë".

Ajo tha se gratë dhe vajzat në zonat e konfliktit përballen me sfida të shumta, por "shpirti i tyre mbetet i pathyeshëm. Ato luftojnë për mbijetesë, luftojnë për liri", u shpreh Osmani, duke shtuar se derisa ato e kanë të pamundur të përdorin zërin e tyre, e gjithë bota duhet të bëhet zëri i tyre.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka marrë pjesë në Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë që po zhvillohet në Kosovë. Fokusi në fjalën e tij ka qenë të roli i grave për paqen dhe sigurinë, por edhe të

konfliktet e hershme në Ballkan, për të cilat ka thënë se çmimin më të rëndë e kanë paguar gratë.

Begaj ka theksuar se ka ende shumë punë për t'i forcuar gratë dhe barazinë gjinore. "Ky takim është dëshmi e zotimit tonë të përbashkët ndaj paqes dhe sigurisë. Reflektojmë për kontributin e Kosovës për një të ardhme përparimtare, ku roli i grave do të jetë themelor. BP ka qenë dëshmitar i konflikteve që kanë lënë shenjë ta paharrueshme në tokat tona, por edhe në zemrat tona dhe gjithmonë do të mbetet në kujtesën tonë historike", ka thënë ai. Sipas presidentit Begaj, ndër ata që kanë mbajtur barrën më të rëndë të këtyre konflikteve janë gratë. "Këto konflikte na shërbejnë si një kujtesë e dhimbshme të çmimit aq të shtrenjtë të paguar veçanërisht të paguar nga gratë. Jemi bërë bashkë për ta ritheksuar përkushtimin ndaj bashkëpunimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm për ta nxitur paqen në Ballkanin Perëndimor", ka thënë ai. Begaj ka theksuar se paqja dhe

siguria nuk mund të garantohen pa barazinë e plotë të burrave dhe grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. "I rëndësishëm është arsimi për gratë dhe vajzat, investimi për arsimin tyre hap jo vetëm mundësi të reja, por i përgatit për t'i sfiduar normat dhe tabutë", ka shtuar Begaj.

Organizimi i Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë kishte qenë zotim i Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci që u mbajt në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 2021.

Forumit këtë vit përqendrohet në përpjekjet për ta luftuar dhunën seksuale në konflikte, por edhe për t'i gjetur mënyrat për t'i ndihmuar gratë dhe vajzat të navigojnë në mënyrë të sigurt teksa përballen me kërcënimet e sigurisë klimatike. "Objektivi i forumit është t'i adresojë kërcënimet ndaj sigurisë së grave teksa po shfaqen sfida të reja të sigurisë, me qëllimin kyç të bashkimit të forcave për ta çuar përpara agjendën e forumit", thuhet në uebfaqen e Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.



Maqedonia e Veriut mbështet hyrjen e Kosovës në KiE

PRISHTINË, 15 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të edicionit të dytë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ka pritur të hënën në takim kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi.

Maqedonia e Veriut, sipas presidentes Osmani, është shtet fqinj dhe mbështetës i Kosovës. Presidentja Osmani tha se Kosova dhe Maqedonia e Veriut

mund t'i shkëmbejnë përvojat në procesin e integritetit evropian dhe në të njëjtën kohë shfaq bindjen se ky shtet do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën evropiane.

Në këtë kontekst, presidentja tha se Kosova llogarit në përkrahjen e mëtejme të Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës, sikurse edhe në NATO, BE dhe organizata

ndërkombëtare.

Në prag të votimit në Asambleenë e Përgjithshme të Këshillit të Evropës, kryeministri Xhaferi e njoftoi presidenten Osmani se mbështetja e Maqedonisë së Veriut është e plotë.

Në këtë takim, ndër të tjera, u diskutua edhe për finalizimin e pikave të përbashkëta kufitare përpara fillimit të sezonës verore, sikurse edhe lehtësimin e të bërit biznes.





Pafuqia e Marrëveshjes së Ohrit për anëtarësim në organizata ndërkombëtare

Në Nenin 4 të Marrëveshjes së Ohrit thuhet qartë se Serbia “nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare”. Por, Serbia ka ngritur një grup punues për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Analistët nuk presin ndonjë lëvizje të madhe në procesin për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë në kohën kur kanë mbetur edhe pak muaj deri te zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe për disa pozita kyçe në BE

PRISHTINË, 15 PRILL - Në Nenin 4 të Marrëveshjes së Ohrit thuhet qartë se Serbia “nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare”. Por, Serbia ka ngritur një grup punues për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Me urdhër të presidentit Aleksandar Vuçiq, grupi përfshin pjesëtarë të Qeverisë dhe të Parlamentit të Serbisë dhe koordinon aktivitetet e tyre kundër anëtarësimin të Kosovës në Këshillin e Evropës. Asambleja Parlamentare e kësaj organizate, që është lidere në Evropë për të drejtat e njeriut, do të votojë për pranimin e Kosovës më 16 prill, ndërsa vendimi përfundimtar pritet në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 16 maj.

Vuçiqi ka kërkuar që si argument kryesor kundër Kosovës të shfrytëzohet refuzimi i saj për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Të mos këmbëngulet se Kosova nuk është shtet. Kjo nuk do të ketë efekt, sepse shumica e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian e kanë njohur Kosovën”, ka thënë Vuçiqi. Themelimi i Asociacionit parashihet, po ashtu, me Marrëveshjen e Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, të cilën palët e kanë arritur më shumë se një vit më parë. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i kësaj marrëveshjeje, insiston vetëm se të dyja vendet duhet ta zbatojnë atë “pa vonesa të tjera”, edhe pse nuk e kanë nënshkruar. Zëdhënësi Peter Stano nuk ka

pranuar t’i komentojë përpjekjet e Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Për komentuesit e çështjeve politike, të vetmit ata që besojnë se Marrëveshja e Ohrit është në të vërtetë marrëveshje, janë zyrtarët e Bashkimit Evropian të përfshirë në ndërmjetësimin e saj. Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në LSE IDEAS - Shkolla e Londrës për Ekonomi, flet për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”: “Këto nuk janë marrëveshje në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, pavarësisht nga ajo që thonë BE-ja dhe ShBA-ja. Kur shikoni të drejtën ndërkombëtare, marrëveshjet, për shumicën e vendeve, duhet të nënshkruhen dhe të ratifikohen. Dhe, siç e dini, e ashtuquajtura Marrëveshje e Ohrit nuk është nënshkruar prej asnjëres palë dhe nuk është ratifikuar”. Lobimi i Serbisë kundër anëtarësimin të Kosovës në organizata ndërkombëtare daton vite para Marrëveshjes së Ohrit dhe ka qenë i suksesshëm në disa raste. Përkundër aplikimeve, Kosova, për shembull, nuk ka arritur të bëhet as pjesë e agjencisë ndërkombëtare të policisë, INTERPOL, as e agjencisë së

Kombeve të Bashkuara për kulturë, UNESCO. Hartwell thotë se Kosova tani “është në një pozitë të ndërlikuar” dhe se nuk mund të presë shumë nga BE-ja. “Pas sulmit terrorist në Banjaskë, BE-ja nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për ta ndëshkuar Serbinë, edhe pse ka shumë indikacione që tregojnë për lidhje të fuqishme midis presidentit Vuçiq dhe terroristëve. Andaj, nuk kam shumë shpresë se BE-ja do të bëjë ndonjë gjë për t’iu përgjigjur Serbisë, e cila përpiqet ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës”, thotë Hartwell. Toby Vogel, nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Bruksel, thotë për “Exposën” se Perëndimi po përpiqet ta përdorë anëtarësimin në Këshillin e Evropës si presion mbi Qeverinë e Kosovës për ta formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ai nuk e përjashton mundësinë që ndonjëri prej vendeve të QUINT-it ta shtyjë votimin në Këshillin e Evropës. “Ajo që mund të bëjë Kosova është ta dorëzojë draft-statutin e Asociacionit në Gjykatën Kushtetuese dhe ta çojë përpara çështjen e formimit të tij. Është një gjë jo e këndshme politikisht, por pa e bërë këtë nuk mendoj se do të ketë përparim drejt anëtarësimin në Këshillin e

Evropës”, thotë Vogel. Mendim të ngjashëm shpreh edhe Hartwelli. “Kjo nuk do ta linte me shumëçka në tryezën e bisedimeve me Serbinë, por do të ndihmonte për të treguar se Kosova është e gatshme të ecë përpara”, thotë ai. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” më 19 mars se çështja e formimit të Asociacionit nuk mund të ndahet nga Marrëveshja e Ohrit apo, siç e quan ai, Marrëveshja bazë. Sipas tij, ato duhet të pranohen paralelisht. “Unë thashë: mirë pra, po e marrim paketën me Marrëveshjen Bazike, Aneksin e zbatimit, draft-statutin me të gjitha vërejtjet e mia, dhe si një paketë po e nënshkruajmë këtu në Bruksel... Pala tjetër refuzoi, ndonëse vërehej një lloj entuziazmi tek udhëheqësit evropianë për propozimin tim. Ju e dini që presidenti i Serbisë po i përmbahet asaj fjalë të tij që e ka një dhembje të madhe në dorë, e cila do të duhej ta nënshkruante këtë marrëveshje”, ka thënë Kurti. Analistët nuk presin ndonjë lëvizje të madhe në procesin për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë në kohën kur kanë mbetur edhe pak muaj deri te zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe për

Lajçaku pret nga Bislimi dhe Petkoviqi të jenë “mendjehapur” në takimin që zhvillohet në fund të javës

PRISHTINË, 15 PRILL - I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka njoftuar për raundin e ri të dialogu midis Kosovës dhe Serbisë, duke shtuar se ai pret që të dyja palët të vijnë në takimin këtë javë me një “mendje të hapur”. “Në fund të kësaj jave do të pres kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë për një raund tjetër bisedimesh për të gjetur një zgjidhje të përkohshme për

njerëzit e prekur nga vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës. Pres që të dyja palët të vijnë në takim me një mendje të hapur, qasje fleksibël, e orientuar drejt zgjidhjes dhe e bazuar në idetë e paraqitura gjatë takimeve të mëparshme”, ka shkruar Lajçak në “Facebook”.

Siç theksoi ai, pasi ka vizituar katër vende të ndryshme gjatë javës së kaluar, ai po shkon në Bosnjë-Hercegovinë dhe ideja kryesore e ngjarjeve të javës së

kaluar ishte se si të kthehej në realitet momenti i zgjerimit të BE-së. Ai shtoi se javën e ka nisur në Sofje të Bullgarisë, ku ka mbajtur fjalim në samitin “Takimi i BE-së në Forumin Ballkanik”. “Nga Bullgaria u nisa për në Poloni për të diskutuar mbi zhvillimin rajonal në Ballkanin Perëndimor me studentët e Kolegjit Evropian në Natolin. Ndërsa isha në Varshavë u takova edhe me nënsekretarin

e shtetit polak Marek Pravda për një diskutim të detajuar rreth rajonit dhe më gjerë. Një ndalesë e shkurtër në Bruksel, vazhdova në Delphi në Greqi për forumin vjetor ekonomik për të folur për Dialogun, Ballkanin Perëndimor dhe mënyrat për ta përmirësuar integrimin në BE. Delphi ishte gjithashtu një mundësi e mirë për të takuar miq, kolegë dhe shkencëtarë politikë”, ka shkruar Lajçak.

Ai ka theksuar se javën e kaluar ka pasur rastin të diskutojë edhe për zhvillimet e fundit në Mal të Zi me nënkryetarin e Qeverisë së Malit të Zi, ministrin e Punëve të Jashtme dhe ministrin për Çështje Evropiane, Gorçeviq. “U bëra thirrje të treve që të qëndrojnë në kursin e reformave të BE-së dhe t'i shmangin fërkimet e brendshme me çmimin e progresit në rrugën e vendit drejt BE-së”, ka shkruar Lajçak.



disa pozita kyçe në BE. Vogel thotë se BE-ja dhe vendet e saj anëtare duhet ta shfrytëzojnë largimin e ndërmjetësuesve evropianë, Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak, si një mundësi për ta rivlerësuar qasjen e tyre aktuale ndaj dialogut Kosovë - Serbi. “Nevojitet një fillim i ri si në personel, ashtu edhe në format të dialogut. Perëndimi duhet t'i ndryshojë stimujt nën të cilët vepron lidhshipi i Kosovës dhe ai i Serbisë. BE-ja dhe ShBA-ja duhet ta kuptojnë se Vuçiçi do të vazhdojë ta luajë lojën e tij aktuale nëse rregullat e lojës nuk ndryshojnë”. “Kjo do të thotë të bëhesh i ashpër ndaj tij për shkak të destabilizimit të rajonit me programin e tij irredentist të

‘botës serbe’, e jo ta ftosh atë për të darkuar në Pallatin Elysee dhe t'i shesësh avionë të avancuar luftarakë”, thotë Vogel. Vogel i referohet një takimi që ka zhvilluar javën e kaluar Vuçiçi me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, në Paris. Pas atij takimi, Vuçiçi ka thënë se ka arritur marrëveshje për blerjen e avionëve luftarakë nga Franca, ndërsa Macroni ka thënë se vendi i tij do të sigurohet që secila pikë e Marrëveshjes së Ohrit të zbatohet. Për më shumë se 13 vjet të përfshira në dialog për normalizimin e marrëdhënieve, Kosova dhe Serbia kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por shumë prej tyre nuk janë zbatuar. Në shtator të vitit 2020, në praninë

e presidentit të atëhershëm amerikan Donald Trump, dy vendet kanë nënshkruar edhe një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike, pjesë e së cilës ka qenë edhe një moratorium njëvjeçar mbi fushatën e Serbisë për çnjohjen e Kosovës. Deri atëherë, Serbia, e mbështetur edhe nga Rusia, ka pretenduar se ka arritur t'i bindë disa vende për t'i tërhequr njohjet e Kosovës, në mesin e tyre: Surinami, Burundi, Liberia, Ishujt Solomon, Madagaskari, Republika Qendrore e Afrikës, Gana, Siera Leone e të tjera. Autoritetet e Kosovës, megjithatë, nuk kanë konfirmuar ndonjë çnjohje. Shteti i fundit që ka njohur

Kosovën ka qenë Izraeli. Njohja është bërë në vitin 2021 dhe ka qenë zotim i Marrëveshjes së Uashingtonit. Kosova vazhdon të mos njihet nga pesë vende të BE-së - Greqia, Rumania, Spanja, Sllovakia dhe Qiproja - dhe kjo, sipas analistëve, është pengesë në vete. Ngurrimi vazhdon përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar në vitin 2010 se pavarësia e Kosovës “nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar”. Sidoqoftë, gjatë 16 vjetëve shtet, vendi ka arritur të bëhet pjesë e disa organizatave të rëndësishme ndërkombëtare - në mesin e tyre: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar,

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komiteti Olimpik e të tjera, ndërsa në dhjetor të vitit 2022 ka aplikuar për t'u anëtarësuar edhe në Bashkimin Evropian. Kosova ka kohë që nuk ka marrë një lajm të mirë sa iu përket organizatave ndërkombëtare - përjashtuar këtu faktin se, nga 1 janari i këtij viti, qytetarët e saj mund të udhëtojnë pa viza në shumicën e vendeve të BE-së dhe disa të tjera. Sytë do të jenë në Strasburg më 16 prill, kur së paku dy të tretat e përfaqësuesve të 46 vendeve anëtare të Këshillit të Evropës duhet ta çojnë dorën lart për ta çuar Kosovën edhe një hap përpara.

Nis faza e dytë e punimeve në projektin madhor të Unazës Qendrore në kryeqytet

PRISHTINË, 15 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka dalë të hënën për të parë nga afër fazën e dytë të punimeve në projektin madhor të Unazës

Qendrore. Ai ka thënë se po vazhdon me sukses faza e dytë e punimeve në projektin madhor të Unazës Qendrore. Sipas Ramës, ky projekt vital lidh lagjen "Arbëria" me

rrethin e Lakrishtës. "Avancimi i punimeve: Duke u përqendruar në realizimin e kësaj faze, synojmë ta lehtësojmë fluksin e trafikut në qendrën e Prishtinës. Kjo

unazë do të operojë me një sistem njëkrahor që pritet t'i reduktojë kolonat dhe të mundësojë një qarkullim më të lirshëm të automjeteve", ka shkruar Rama në "Facebook".



Konjufca dhe Kurti nderojnë të rënë në Sllovi të Lipjanit



LIPJAN, 15 PRILL - Në përkujtim dhe nderim të të vrarëve dhe të masakruarve shqiptarë në masakrën e Sllovisë së Lipjanit, të kryer nga forcat pushtuese serbe, të hënën, në 25-vjetorin e saj, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial të varrezave në këtë fshat. Gjatë bashkëbisedimit me familjarë të dëshmorëve dhe martirëve të këtij fshati, kryetari Konjufca theksoi se masakrat e kryera gjithandej Kosovës janë akte të qarta të gjenocidit që shteti i Serbisë

ushtroi mbi popullin shqiptar të Kosovës për të cilat Kosova nuk do të pushojë asnjëherë së kërkuari drejtësi. Kreu i Kuvendit tha se këto ditë janë ditë të dhimbjes, por edhe të krenarisë, për arsye se gjaku i dëshmorëve dhe martirëve qëndron në themelet e lirisë dhe të shtetit tonë. Më 15 dhe 16 prill të vitit 1999 policë, ushtarë dhe paramilitarë serbë, në kuadër të operacioneve gjenocidale kundër popullatës civile shqiptare në Kosovë, vranë dhe masakruan në Sllovi të Lipjanit 45 civilë të pafajshëm shqiptarë dhe plagosën shumë të tjerë.

"Termokos"-i njofton se do të vazhdohet furnizimi me ngrohje

PRISHTINË, 15 PRILL - Ndërmarrja Publike "Termokos" ka njoftuar se do të vazhdojë furnizimi me ngrohje edhe për disa ditë pasi parashikohet që në ditët në vijim do të ketë rënie të temperaturave, kështu ka bërë me dije kryeshefi i ngrohtores, Fisnik Osmani: "Pas konsultimeve me Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës, për shkak të

parashikimeve për rënie të temperaturave në ditët e ardhshme, ngrohësja do ta vazhdojë furnizimin me ngrohje edhe për disa ditë". Sipas Osmanit, furnizimi me ngrohje në ditët që do të ketë temperatura më të mira do të vazhdojë me ngarkesë minimale, ndërsa përgjatë ditëve, kur sipas parashikimeve meteorologjike do të ketë rënie të temperaturave të ajrit,

furnizimi me ngrohje do të jetë në harmoni me nevojat e konsumatorëve tanë për ngrohje. "Mosndërprerja e përkohshme e furnizimit me ngrohje është bërë edhe me qëllim për ta ruajtur sigurinë e operimit të sistemit të ngrohjes, i cili, pas përqendimit të motit, do të duhet rikthyer prapë në funksion", ka bërë me dije Osmani.



Në Mitrovicë përkujtohet masakra serbe në rrugën e Kovaçëve



MITROVICË, 15 PRILL - Në 25-vjetorin e masakrës në rrugën e Kovaçëve në Mitrovicë, kryetari i komunës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, kryesuesja e kuvendit të komunës, Vesa Broja, drejtorë të drejtorive dhe asamblistë, kanë bërë homazhe te pllaka përkujtimore ku janë të

vendosur emrat e të rënëve, e ku të pranishëm ishin edhe familjarët e viktimave. Hamza në fjalën e tij tha se kjo ishte masakra më e madhe e forcave policore serbe që kanë bërë brenda qytetit të Mitrovicës ndaj popullatës së pafajshme shqiptare. "Më 14 prill 1999 Mitrovica u shndërrua në dëshmi të

tmerrit. Qytetarë të pafajshëm e civilë u privuan nga jeta në mënyrë barbare me vrasje dhe masakër nga forcat serbe për të vetmen arsye se ishin shqiptarë", është shprehur kryetari Hamza. Në këtë masakër, që është një ndër më të mëdhatë në komunën e Mitrovicës, forcat serbe kanë vrarë 31 shqiptarë.

Sindikata e Arsimit paralajmëron protestë më 1 maj

PRISHTINË, 15 PRILL - Sindikata e Arsimit ka paralajmëruar se nëse qeveria nuk shqyrton kërkesat dhe shqetësimet e paraqitura nga kjo sindikatë do të ndërmerren veprime sindikale. Drejtues të kësaj sindikate

kanë bërë me dije se më 1 maj do të organizohet një protestë, kurse në rast se kërkohet nga anëtarësia, do të vazhdohet edhe më grevë të përgjithshme në sistemin arsimor. Nënkryetarja e Sindikatës së Arsimit, Vjollca Shala, i ka

thënë "Radio Kosovës" se hapat e paralajmëruar janë detyruar t'i marrin pasi po mungon dialogu social ndërmjet SBASHK-ut dhe Ministrisë së Arsimit. "Meqenëse po e shohim që nuk po vendoset dialogu social ndërmjet sindikatës

dhe Ministrisë së Arsimit, ne fillimisht do të fillojmë me një protestë e cila do të mbahet më 1 maj. Mandej do të fillohet me grevë njëorësh, pastaj dyorësh e pastaj njëditëshe. Urojmë që të mos shkojmë me grevë të përgjithshme, që gjithë



procesi mësimor të ndërpritet në Kosovë", ka theksuar ajo.

Hajdari jep sqarime në Prokurorinë Speciale për rezervat shtetërore

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë, Rozeta Hajdari, ka përfunduar të hënën deklaratën në Prokurorinë Speciale. Hajdari ka thënë para gazetarëve se nuk është intervistuar, por ka ardhur të japë sqarime pranë prokurorisë për legjislacionin që është në fuqi për rezervat shtetërore. “Kjo kërkon qartësi në legjislacionin në fuqi që është Ligji për Rezervën Shtetërore, Ligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

dhe ligjet e tjera, prandaj derisa t’i marrim qartësitë përkatëse, ne do ta bëjmë kërkesën dhe të vijmë t’u japim përgjigjet që kanë nevojë t’i marrin”, u shpreh ajo. Me urdhër të Prokurorisë Speciale, Policia e Kosovës kishte arrestuar tre persona të dyshuar se kanë bërë keqpërdorime sa iu përket blerjeve të rezervave shtetërore. Prokuroria Speciale e Kosovës tha se të arrestuarit dyshohen për veprat penale “keqpërdorim i detyrës

zyrtare” dhe “dhënie e ndihmës në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare”. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) kishte konfirmuar se dy prej të arrestuarve janë zyrtarë të saj. Përmes një komunikate për medie Prokuroria Speciale, e cila e ka dhënë urdhrin për arrestime, kishte njoftuar se të arrestuarit janë Hafiz Gara, Irfan Lipovica dhe Ridvan Muharremi.



ASK-ja: Deri më tani janë regjistruar mbi 200 mijë qytetarë, ka interesim edhe nga serbët



PRISHTINË, 15 PRILL - Dhjetë ditë pasi në Kosovë ka nisur regjistrimi i popullsisë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), janë regjistruar mbi 200 000 banorë rezidentë nga të gjitha komunitetet.

Avni Kastrati, kryeshf ekzekutiv në ASK, në një konferencë për medie të hënën, tha se deri më tani janë regjistruar edhe banorë të komunitetit serb nga katër komunat veriore të Kosovës. “Ka edhe pjesëmarrës nga komuniteti

serb nga të gjitha komunat e veriut. Ne mendojmë që në ditët në vijim një pjesë e madhe e tyre do të jetë pjesë e regjistrimit”, tha ai.

Ky njoftim vjen pasi më 5 prill Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit, tha më 5 prill se serbët nuk do të marrin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë në vitin 2011 nuk ishte

mbajtur në katër komunat në veri Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - të banuara me shumicë serbe, ndërsa serbët nga komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit, kryesisht e kishin bojkotuar procesin.

Sipas statistikave që ASK-ja publikoi në një konferencë për medie, deri më tani janë regjistruar rreth 206 000 mijë banorë të deklaruar si shqiptarë, afër 2 000 të deklaruar si serbë dhe në shifra më

të vogla nga komunitetet e tjera në Kosovë. Sipas të dhënave, 93 persona deri më tani kanë preferuar mos të deklarojnë mbi etninë.

Në konferencën për medie më 15 prill, zyrtarët e ASK-së thanë se kanë pranuar disa ankesa mbi punën e regjistruarëve në terren. “Kemi qenë të detyruar t’i shkëpusim disa kontrata të regjistruarëve për shkak se i kanë tejkaluar kompetencat që kanë marrë gjatë trajnimeve”, tha

Kastrati, pa specifikuar arsyet. Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i kaluar i popullsisë, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është rreth 1.8 milion, prej të cilëve rreth 25 000 janë serbë. Megjithatë, sipas vlerësimeve të organizatave joqeveritare serbe në Kosovë, në Kosovë jetojnë rreth 100 000 pjesëtarë të komunitetit serb. Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë zhvillohet nga data 5 prill deri më 17 maj.

Bislimi kërkon heqjen e masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës

PRISHTINË, 15 PRILL - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, priti sot në takim zëvendësdrejtorin menaxhues për Evropë të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) të BE-së, Marko Makovec. Gjatë takimit zëvendëskryeministri Bislimi theksoi nevojën për heqjen sa më parë të masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës gjersa ato vijnë të mbeten të padrejta. “Theksoi

edhe domosdoshmërinë e avancimit tutje të vendit tonë në rrugëtimin drejt integritimit evropian, veçanërisht trajtimit të aplikimit tonë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ku mbetemi i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor ende pa statusin e vendit kandidat, përkundër ecurisë pozitive dhe shënimit të progresit jo vetëm në zbatimin e reformave, por edhe performancës së lartë në fusha kyçe si, ekonomia, sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit

dhe korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe liria e medieve”, është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Më tej u bë me dije se në këtë takim u trajtuan edhe zhvillimet e fundit në vend e rajon, fuqizimi i bashkëpunimit rajonal, vizioni i planit të rritjes si instrument që duhet të ndihmojë në konvergencën mes shteteve të rajonit, por edhe atë me BE-në dhe perspektiva e zhvillimit dhe prosperitetit në shtetin tonë.



Nesër hapet në Prishtinë Panairi i Turizmit dhe Edukimit

PRISHTINË, 15 PRILL - Edicioni i 20 i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit i hap dyert për vizitorë më 16-17 prill 2024 në sallën 1 Tetori në Prishtinë me fillim nga 10:00. Me mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shumta, manifestimi i sivjetshëm premtom të jetë festë e turizmit dhe e sportit. Panairi shërben si një platformë për ta shfaqur trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike,

peizazhet e ndryshme dhe përvojat emocionuese sportive të Kosovës dhe më gjerë. Nga turizmi kulturor dhe historik deri te sportet aventureske, panairi ofron një eksplorim gjithëpërfshirës të të gjitha aspekteve të turizmit dhe sportit. Po më 16 prill në sallën 1 Tetori hapet edhe panairi i edukimit, karrierës dhe punës. Si ngjarja më e madhe edukative në Kosovë, panairi bashkon edukatorë,

institucione dhe profesionistë nga mbarë bota. Duke ofruar një platformë për angazhim të drejtpërdrejtë midis institucioneve arsimore dhe studentëve, panairi paraqet programe, produkte dhe shërbime inovative që formojnë të ardhmen e arsimit. Këtë panair e bën edhe më të veçantë bashkëngjitja e komponentit të Karrierës dhe Punës, Thirrje për të gjithë studentët që kanë nevojë për pune praktike dhe për të gjithë punëkërkuet.



Aktakuzë kundër katër zyrtarëve të ndërmarrjes 'Trepça'

MITROVICË, 15 PRILL - Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda - ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë kundër të pandehurve H. U., Q. B., S. I. dhe Xh. T. për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", dhe ndaj Xh. T. edhe për veprën penale "Konflikt i interesit".

Sipas njoftimit për medie, të pandehurit H. U., Q. B., S. I. akuzohen se në cilësinë e personave zyrtarë në ndërmarrjen "Trepça" SH. A, me dashje, duke e shfrytëzuar detyrën zyrtare, i tejkalojnë kompetencat e tyre dhe nuk përmbushin detyrën zyrtare me qëllim që personi A. T. të përfitojë dobi, ashtu që, duke mos



përfillur dispozitat ligjore për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, i pandehuri H. U., në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe të pandehurit Q. B., S. I., në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranimin e një punonjësi - vozitësi

të menaxherit në ndërmarrjen "Trepça" Sh. A., e përpilojnë dhe nënshkruajnë raportin për propozimin e kandidatit të vetëm A. T. për pranimin në pozitën e shoferit, edhe pse e kanë ditur se në këtë rast duhet përsëritur konkursi pasi që nuk kanë qenë tre

kandidatë që i plotësojnë kushtet me konkurs.

Ndërsa i pandehuri Xh. T., në cilësinë e personit zyrtar u. d. menaxher i ndërmarrjes "Trepça" Sh. A., akuzohet se me dashje nuk i përfillë dispozitat ligjore, duke tejkaluar kështu kompetencat e tij dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për personin A. T., ashtu që konkursi për pozitën vozitësi i menaxherit të ndërmarrjes "Trepça" Sh. A., edhe pse është dashur të jetë i hapur pesëmbëdhjetë ditë nga data e publikimit, i njëjti konkurs ka mbetur i hapur vetëm tetë ditë, po ashtu është dashur të përsëritet konkursi pasi që nuk kanë qenë tre kandidatë që i plotësojnë kriteret e parapara me konkurs.

Po ashtu, i pandehuri Xh. T., në

cilësinë e personit zyrtar u. d. menaxher i ndërmarrjes "Trepça" Sh. A., me dashje nuk i përfill dispozitat ligjore të "Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik" dhe merr pjesë personalisht në çështje zyrtare në të cilën anëtari i familjes së tij ka interes financiar, ashtu që merr vendimin nr. 809 të datës 29.03.2019 mbi pranimin në marrëdhënie pune të vëllait të tij A. T. në kohë të pacaktuar në pozitën "Vozitës" në këtë ndërmarrje.

Me këto veprime të pandehurit kanë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë.

Prokurori i Shtetit i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtorë për veprat e kryera penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Një delegacion i BQK-së po merr pjesë në takimet pranverore të FMN-së dhe të BB-së në Uashington

PRISHTINË, 15 PRILL - Një delegacion i lartë i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, po merr pjesë në takimet pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) që po mbahen në Uashington.

Delegacioni i BQK-së do të ketë takime me zyrtarë të lartë të FMN-së dhe të BB-së, ku do të diskutohet mbi zhvillimet e fundit ekonomike, fiskale dhe financiare dhe pritjet e mëtejshme.

Në takimet që do të zhvillohen nga 15 deri më 21 prill, guvernatori Ismaili do t'i paraqesë prioritetet për sektorin financiar në pajtim me objektivat dhe planin strategjik të

BQK-së, përditësimin lidhur me zbatimin e programeve dhe asistencave teknike profesionale, përfshirë nevojat e reja për mbështetje profesionale.

Në kuadër të vizitës zyrtare në ShBA, përfaqësuesit e BQK-së do të kenë takime bilaterale me drejtuesit e Departamentit Thesarit të ShBA-së, Bankës Federale të Nju-Jork - FED (Banka Qendrore Amerikane), si dhe me homologët nga bankat qendrore partnere.

Në kuadër të takimeve pranverore të FMN-së dhe të BB-së, guvernatori Ismaili do të takohet me zëvendës drejtorin menaxhues të FMN-së, Bo Li, drejtorin e Departamentit Evropian të FMN-së,



Kammer, zëvendës presidenten e BB-së për Evropën dhe Azinë Qendrore, Bassani, zëvendës presidentin e BB-së, njëherësh drejtor i Thesarit, Familjar, drejtorët ekzekutivë të konstituencave të FMN-së dhe BB-

së, Palotai dhe Demircan. Gjithashtu, delegacioni i BQK-së do të ketë takime me drejtues dhe zyrtarë të lartë të institucioneve financiare për bashkëpunim në fusha të interesit. Paraprakisht në Boston të ShBA-së

guvernatori i BQK-së takoi drejtues të Universitetit të Harvardit, duke përfshirë dekanin e Harvard Kennedy School, Elmendorf dhe profesorë eminentë që kanë shërbyer në pozita të rëndësishme shtetërore, si kryeekonomistë, drejtues të Departamentit të Thesarit, anëtarë të Bordit të Rezervës Federale (FED Board), këshilltarë të ekonomisë në Shtëpinë e Bardhë.

Guvernatori Ismaili vizitën me ftesë të Universitetit e përmbylli me një ligjëratë para studentëve dhe publikut në kompleksin e Harvardit, me temën "Tejkalimi i sfidave të sistemit financiar: rasti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës".

Grupi i Miqësisë me Kanadanë në Kuvendin e Kosovës takohet me Rob Oliphant, flasin për bashkëpunimin ekonomik

PRISHTINË, 15 PRILL - Grupi i Miqësisë me Kanadanë në Kuvendin e Kosovës, nën drejtimin e kryetares Mimoza Kusari-Lila dhe deputetit Armend Zemaj, zhvilloi takim me Rob Oliphant, anëtar i Parlamentit dhe sekretar parlamentar i ministrit të Punëve të Jashtme të Kanadasë.

Takimi filloi me shkëmbimin e informacioneve rreth sistemeve politike të dy vendeve, duke vazhduar me diskutimin për një varg

çështjesh të rëndësishme politike (përfshirë tranzicionin kompleks politik të Kosovës para dhe pas shpalljes së pavarësisë, sfidat në përfaqësimin rajonal dhe ndërkombëtar) dhe të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në nevojën për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, përfshirë edhe të drejtat e komunitetit LGBTQ+ në vend.

Gjithashtu u bisedua edhe për potencialin e madh të

bashkëpunimit ekonomik në sektorë të rëndësishë së veçantë për Kosovën, bashkëpunimin ushtarak, si dhe domosdoshmërinë e procesit të lehtësimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve nga Kosova për në Kanada.

Në fund të takimit Grupi i Miqësisë me Kanadanë falënderoi palën kanadeze dhe vlerësoi bashkëpunimin dhe angazhimin e Kanadasë për Kosovën në të gjitha fushat, duke mirëpritur bashkëpunimin e ardhshëm.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (18)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-117- Kongresi i Partisë së Shqipërisë

1. Kongresi i 8-të i Partisë së Punës së Shqipërisë u mbajt më 1-7 nëntor, pesë vjet që nga Kongresi i fundit dhe dyzet vjet që kur u themelua Partia. Në fjalimet e tyre, Sekretari i Parë Enver Hoxha dhe Kryeministri Mehmet Shehu analizuan me një gamë mbresëlënëse përqindjesh në rritje periudhën që prej vitit 1976 gjatë së cilës thuhej se ekonomia ishte mbështetur me sukses në burimet e veta material pa ndonjë përfitim të ndihmës së huaj apo huaje që prej prishjes me Kinën në vitin 1978, kur 50% e tregtisë së huaj shqiptare që zhvillohej me një vend të vetëm, duhej të kalonte menjëherë tek vendet e tjera. Sipas shifrave shqiptare, 41% e tregtisë së saj bëhet me vendet e Evropës Lindore dhe 59% me vendet Perëndimore përfshirë Jugosllavinë, e cila aktualisht është partneri i saj kryesor tregtar. Sukseset e një politike të vetëmbështetjes ekonomike ishin të dukshme në ekonomi, ku për herë të parë importet dhe eksportet pretendohesh se ishin në balancë, si dhe në bujqësi, e cila tashmë plotëson nevojat e vendit me grurë dhe artikuj ushqimorë dhe siguron tepriçë për eksport. Vendi është i pavarur nga importet e naftës dhe është në gjendje t'i eksportojë Jugosllavisë disa nënprodukte të naftës dhe energji elektrike nga një rrjet i gjerë hidroelektrik. Kjo politikë duhet të vazhdojë gjatë Planit të 7-të Pesëvjeçar (1981-1985), ku do të parashikohet që 46% e investimeve të shkojë për industrinë, veçanërisht atë metalurgjike dhe nxjerrjen e naftës dhe mineraleve. Bujqësia do të marrë 29% të instrumenteve që do t'i kushtohen rritjes së prodhimit të artikujve ushqimorë për të furnizuar nevojat e brendshme si dhe për të parashikuar eksportin e produkteve të përpunuara dhe të papërpunuara. Fermat kooperativë duhet të zhvillohen më tej dhe disa prej tyre duhet të shndërrohen në ferma më të mëdha shtetërore ndërkohë që tokat private do të kufizohen. Duhet të zgjerohet sistemi hekurudhor që u krijua pas luftës dhe të ndërtohet një linjë deri në kufi, e cila do ta lidhë Shqipërinë eventualisht me rrjetin jugosllav. Asnjë folës nuk përmendi asnjë problem nga i cili me siguri, ekonomia duhet të jetë duke vuajtur.

2. Nuk ka asnjë ndryshim në politikën e jashtme, dhe qëndrimet armiqësore të mbajtura për një

kohë të gjatë ndaj bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara do të mbeten të njëjta pa asnjë perspektivë të menjëhershme për ndonjë rikthim të marrëdhënieve diplomatike. Kthimi i arit shqiptar i periudhës së para luftës që ruhet nga një komision tre-palësh dhe ndaj të cilit Britania ka pretendimin e saj, mbetet ende një kusht paraprak për çdo rikthim të marrëdhënieve me Mbretërinë e Bashkuar. Shqipëria ka sot marrëdhënie diplomatike me 85 vende, një rritje prej 21 që prej Kongresit të fundit. Marrëdhëniet me fqinjët e saj të Ballkanit janë të mira megjithëse marrëdhëniet me Jugosllavinë janë ndikuar negativisht nga mbështetja e saj duke bërë thirrje për t'i dhënë Kosovës statusin e Republikës në atë vend. Megjithatë, Hoxha tha se nuk kishte pretendime territoriale ndaj Jugosllavisë dhe as ndonjë kërkesë për rregullimin e kufijve. Ai bëri thirrje për paqe dhe stabilitet në Ballkan pa ndërhyrjen e superfuqive, por nuk shkoj deri aty sa të mbështeste propozimet e fundit të Bullgarisë për një zonë pa lëndë bërthamore në rajon. Kjo shmangie e angazhimeve multilaterale, përveç anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe disa organe të tjera ndërkombëtare, ishte po ashtu e dukshme në vërejtjet e tij të ashpra për deklaratën "farsë" të Helsinkit dhe planet "imperialist" të mos-angazhimit dhe rendit të ri ekonomik ndërkombëtar.

3. Vendi është bashkuar rreth Partisë, e cila do të vazhdojë t'i përmbahet me rreptësi interpretimit të saj të Marksizëm-Leninizmit, duke hedhur poshtë çdo ndryshim të parimeve bazë dhe duke dënuar politikën e pretenduar revizioniste të partive të tjera komuniste. E vetmja parti sunduese që dërgoi një delegat në Kongres, ishte Partia vietnameze, ku të ftuarit e tjerë ishin nga grupe fraksioniste Marksiste-Leniniste përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Revolucionare Komuniste të Britanisë së Madhe (Marksiste-Leniniste), Z. David Williams. Anëtarësimi në Parti tani qëndronte në 122,000 ose 4.5% të popullsisë (2,700,000). Tetëdhjetë e një anëtarë u zgjodhën në Komitetin Qendror, ku moshë mesatare ishte 49 vjeç dhe për herë të parë ka në përbërje përfaqësues nga shkenca dhe artet. Hoxha foli për nevojën për të sjellë gjak të ri në udhëheqje dhe kjo solli futjen e anëtarëve të rinj në Byronë Politike, e cila aktualisht ka 13 anëtarë. Por shumica, përfshirë Hoxhën dhe Shehun, respektivisht 73 dhe 68 vjeç, ishin të rrizgjedhur.

-118- Citime nga raporti i Enver Hoxhës paraqitur në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës së Shqipërisë mbajtur nga data 1-7 nëntor 1981

1. Ndërhyrja në punët e brendshme të RSF të Jugosllavisë: "Ne prisnim që përmes fitores në Luftën e Dytë Botërore, popujt e të

dy vendeve do të korrigjonin gabimet tragjike të së kaluarës". "Trajtimi i gabuar në zgjidhjen e çështjeve kombëtare në Jugosllavi daton që në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist (AVNOJ), mbajtur në Jajcë në nëntor 1943. Në këtë mbledhje zonat ku banonin shqiptarët në Jugosllavi, u përdorën si mjet për të rregulluar shkëmbimet territoriale të popullsisë ndërmjet Republikave dhe Federatës, veçanërisht ndërmjet Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi". Pjesa më e madhe e Kosovës i është dhënë Serbisë dhe pjesa e mbetur është ndarë midis Maqedonisë dhe Malit të Zi.

"Republika e Kosovës do të kishte sjellë përqendrimin territorial të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, gjë që do të kishte shkaktuar shkëputjen e disa zonave të populluara nga shqiptarët prej Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë dhe përfshirjen e tyre në territoret shqiptare".

2. Pretendimet territoriale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në drejtim të RSF të Jugosllavisë:

"Gjatë bisedës time me Titon në vitin 1946, unë shpreha mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe pjesë të tjera të populluara nga shqiptarët, i përkisnin Shqipërisë dhe se ato duhet t'i ktheheshin asaj. Shqiptarët luftuan për lirinë dhe sovranitetin e Shqipërisë në të cilën duhet të përfshihen pjesët e tjera shqiptare në Jugosllavi". "Parimet themelore të Federatës jugosllave përmblajnë padrejtësi në drejtim të popullsisë shqiptare: shqiptarët nuk mund të mbajnë më barrën e kombinimeve, që u krijuan dikur në kurriz të tyre".

3. Kushtëzimi i marrëdhënieve dhe nxitja e armiqve në Jugosllavi "Shqipëria dëshiron që marrëdhëniet shtetërore dhe të tjera me Jugosllavinë të ndiqen në mënyrë normale, por kjo do të varet nga qëndrimi i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë socialiste, si dhe nga trajtimi i shqiptarëve në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Jugosllavisë".

"Nëse udhëheqja aktuale

jugosllave dëshiron të ndjekë rrugën tashmë të zgjedhur, kundërshtimi nga ana e shqiptarëve do të vazhdojë dhe do të intensifikohet akoma më tej".

119- Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
17 nëntor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Charles,

Kosova: situata e sigurisë

1. Charles Crawford ka shkruar javën e kaluar se trazirat kanë filluar sërish në Universitetin e Prishtinës. Ky fakt është thjesht një tregues i rritjes së aktivitetit armiqësor në Krahinë gjatë një apo dy javëve të fundit.

2. Në mbledhjet e mbajtura në Prishtinë javën e kaluar nga Lidhja Socialiste, Subnor dhe Kuvendi i Prishtinës, u shqyrtua situata e sigurisë dhe u vlerësua "ende e ndërlikuar megjithëse në tërësi ishte në shkallë të konsiderueshme më e mirë sesa disa muaj më parë". Sidoqoftë, më 15 nëntor, shtypi vazhdoi të raportonte se "gjatë ditëve të fundit ishte bërë e dukshme se situata po bëhej gjithnjë e më e ndërlikuar". Duket se shpërndarja e pamfleteve është forma më e shpeshtë e aktivitetit armiqësor dhe në Dubroshevc dhe Glogovc janë zbuluar shtypshkronja të paligjshme që nxjerrin gazetën "Bashkimi". Gjithashtu ka pasur raportime për parulla me gjatësi 80-100 m të shkruara në rrugë. Një pjesë e aktivitetit duket se ka marrë formë më të dhunshme në faktin që, sipas një raporti të shtypit më 17 nëntor, forcat e sigurisë së Prishtinës kanë shënuar sulme ndaj individëve dhe rrëmbime personash.

3. Mund të ketë të dhëna të tjera për këtë mbledhje të sotme të Komitetit Qendror mbi platformën e re politike për Kosovën. Megjithatë, duket se të gjitha masat

e marra deri më tani nuk janë duke pasur sukses në shtypjen e nacionalistëve.

I Juaji
T. J. Crank
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-120- Konfidenciale

N H R A Broomfield Esq
Ambasada britanike
Beograd
23 nëntor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Nigel,

Vizitat për të hyrë e dalë nga Jugosllavia

1. Letra juaj për Curtis Keeble e datës 30 tetor mbërriti pasi isha larguar për në Londër. Siç do t'ju kujtohet, kemi biseduar për këtë çështje dhe e kam diskutuar edhe me Charles Gray. Mbase do të ishte e dobishme që të hidhja në letër këndvështrimin tim për këtë pikë. Vlerësime të përgjithshme

2. Tre faktorët që duhet të kemi parasysh vitin e ardhshëm, janë: (a) Do të mbahen zgjedhjet e reja nga mesi i prillit deri në formimin e Qeverisë së re afërsisht në mesin e majit.

(b) Kongresi i 12-të i Partisë do të mbahet në qershor: datat e sakta nuk janë shpallur ende. (c) Unë do të largohem më e shumta më 19 tetor dhe mendoj se do të bëj gati valixhet rreth 1 tetorit. Pasuesi im duket se nuk do të arrijë deri pas pak kohësh në nëntor.

Sekretari i Shtetit
3. Jam i kënaqur që Sekretari i Shtetit ka vendosur t'i kthejë kaq shpejt vizitën Vrhovecit. Kjo do t'i japë mundësinë që të takojë Ministrin e Jashtëm jugosllav në fillim të ushtrimit të detyrës së tij. Më keni njoftuar se ai do të vijë në korrik ose në vjeshtë. Nëse është fjala për vjeshtën, shpresoj që të ndodhë në shtator, megjithëse mbledhja e UNGA mund të shkaktojë probleme. Nëse bëhet fjalë për korrikun, në gjysmën e



parë të muajt do të ishte më mirë se të dytën, d.m.th. para se të fillojë sezoni i pushimeve lokale. Por jam i sigurt se, edhe nëse është i vlefshëm vetëm opsioni i dytë, jugosllavët përsëri do të pranenin.

4. Keni ngritur me mua problemin e Bullgarisë, duke thënë se, nëse isha kundër kombinimit të vizitave në të dyja vendet, rrezikonim që të humbnim atë të Beogradit. Unë thashë se, nëse ishte kështu, le ta zhvillojmë vizitën këtu që përbën një faktor më të rëndësishëm dhe të sigurojmë shpjegimet e nevojshme lokale. Mendoj se jeni dakord që Sekretari i Shtetit të kalojë tre ditë këtu dhe të vijë në Beograd përpara Sofjes.

Lord Trefgarne

5. Nëse e kujtoj saktë, ramë dakord që Lord Trefgarne mund të alternonte vizitën me Lordin Carrington. Nëse ky i fundit vjen në vjeshtë, tjetri mund të vijë më herët, p.sh. në korrik. Do të bëjmë të pamundurën për të siguruar që të vizitohet Republika të ndryshme. Mbi të gjitha, duhet të shmangim vizitën e Lord Carrington në Maqedoni. Mund të sugjeroj Bosnjën/Hercegovinën. Lord Trefgarne mund të shkojë në Mal të Zi ose Maqedoni (ose nëse është e hapur për ftesa zyrtare, edhe në Kosovë), megjithëse vitin e kaluar Kryeministri vizitoi Shkupin dhe Z. Parkinson Titogradin. Fjala e fundit i takon mikpritëseve jugosllavë, pasi duhet të ruajmë një model barazie në vizitat e dy të huajve të rëndësishëm në Republika.

Z. Nott

6. Mendoj se ishte Charles që më tha se Z. Nott po planifikonte të vinte këtu për vizitë për Pashkë ose për Ditën e Rrëshajave. Pengesa për Pashkë është se mikpritësi, Gjeneral Ljubiçiq, nuk do të jetë më Ministër i Mbrojtjes që nga mesi i majit. Kështu, nëse do të vijë atëherë, Z. Nott nuk do të krijojë marrëdhënie personale me personin e ngarkuar së paku për katër vitet e ardhshme. Dita e Rrëshajave, 31 maji, do të ishte mirë nga ky këndvështrim, e po ashtu edhe qershori, me kusht që Z. Nott të shmangë javën e Kongresit. Por, nëse mundësia e vetme mbetet vetëm dita e Pashkëve, sugjeroj që ta pranohet këtë pasi edhe nëse Z. Nott nuk arrin të takojë Ministrin e ri, ai do të na ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve me Ministrin e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura.

Markoviq

7. Siç e dini, jemi ende në pritje që të sqarohet çdo gjë për këtë vizitë të brendshme. Sa më shumë që të vonohemi, aq më pak ka të ngjarë që ta realizojmë para zgjedhjeve në mesin e prillit; e kuptoj që, meqenëse Lord Trefgarne është mikpritësi i propozuar, lidhja përmes Parlamentit do të reduktohet. Sidoqoftë, ende mendoj se kjo lidhje është e rëndësishme. Kuvendi Federal po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm këtu.

Krijimi i PUS

8. Jam vënë në dijeni se Anthony Acland do të vijë kryesisht për të takuar stafin. Në të njëjtën kohë, nëse deri atëherë është emëruar një "PUS" jugosllav, do të bëj përpjekje për të rregulluar një takim. Jam informuar nga

Anthony se do të ndryshojë pak datat, pra do të vijë diku rreth dateve 14/15 janar, gjë që është e përshtatshme për ne.

Bullard

9. Siç e kam përmendur, për të rregulluar vizitat, Julian mund të mendojë të vijë në shkurt. Por e di që ai nuk mund të vendosë deri në fund të vitit.

Kryeministri i Jugosllavisë

10. Znj. Thatcher ka ftuar Kryeministrin për të kthyer vizitën në Mbretërinë e Bashkuar. Gjuranoviç, titullari në detyrë do të zëvendësohet në maj. Sugjeroj që ta lëmë vizitën e kthimit për pasuesin e tij në vitin 1983.

Sekretari i Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme

11. SFPJ i Jugosllavisë na ka njoftuar se po shqyrtojnë mundësinë që të ftojë Sekretarin e Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme për të vizituar Jugosllavinë. Mendoj se kjo nuk do të mirëpritët në Londër kryesisht për faktin se jugosllavët do ta shihnin si një rast për të ngritur çështje të pakëndshme për emigrantët e tyre në Mbretërinë e Bashkuar. Nga ana tjetër, mund të ishte me vlerë që t'i përgjigjeshim përmes një Ministri pasi kjo do të na jepte mundësinë të diskutojmë çështje të tilla si lënda narkotike, Interpoli, etj.

I Juaji
E. Bolland

-121- Referencë

Z. Gray
1 dhjetor 1981
EESD

Dënimet në Kosovë

1. Mund të keni parë në gazetën "The Times" të datës 1 dhjetor një letër të Z. Harry Hodgkinson ku komenton për dënimet me burg të vendosura për shqiptarët në Kosovë.

2. Ai është Kryetar i Shoqatës anglo-shqiptare, anëtarësia e së cilës përbëhet nga të mërguar në këtë vend dhe një numër britanikësh që kanë interes për Shqipërinë. Natyrisht ai e ka bazuar letrën e tij në një njoftim për shtyp të nxjerrë për këtë temë nga Komiteti Demokratik Kombëtar për një Shqipëri të Lirë (referuar në përkujtesën time të datës 20 nëntor). Përfaqësuesi i Komitetit të Mbretërisë së Bashkuar, Z. Skënder Dume, është gjithashtu anëtar i Shoqatës.

P Rennie
Seksioni i Evropës Lindore
Departamenti i Kërkimit
G 61/3 233 3371

-122- Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
1 dhjetor 1981
FCO
I nderuar Charles,

Kosova: kryesia serbe diskuton shpërnguljen e serbëve dhe malazezëve

1. Më 25 nëntor, gazeta "Politika" raportoi mbledhjen e ditës së djeshme të kryesisë serbe, e cila i kushtoi vëmendjen kryesore problemit të shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova. Por, në këtë mbledhje dolën gjithashtu edhe disa pika të tjera interesante. Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve

2. Duke shqyrtuar këtë çështje si pjesë e vlerësimit të saj të përgjithshëm të ngjarjeve kundërrivolucionare në Kosovë, kryesia arriti në një konkluzion të hapur: Shkaqet e shpërnguljes duhet të gjendenin "kryesisht në klimën sociale dhe politike të një situatë që ishte zhvilluar prej një kohe të gjatë në Kosovë, në forma të ndryshme të presionit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe në arsyet ekonomiko-sociale, të cilat kishin lënë ndjenja pasigurie në mesin e serbëve dhe malazezëve të Kosovës".

Megjithëse, aktualisht po merreshin masa zyrtare, rezultatet nuk ishin të kënaqshme - shpërngulja vazhdonte. Tashmë ishte e nevojshme që të bëhej "progres radikal". Duhet të përshpejtohej aksioni politik dhe organet përgjegjëse në të gjitha nivelet duhej të dënonin ata që ushtronin presion dhe të zbatonin ligjin me rreptësi. Autoritetet e Kosovës, por në veçanti departamentet për çështjet e brendshme, mbanin përgjegjësi të veçantë në këto detyra. Kryesia deklaroi se nëse ishin marrë hapat e duhura, familjet që ishin dëbuar nga presioni duhej bërë e mundur që të ktheheshin; sidoqoftë, duhej të ndiqeshin mundësitë që të kompensoheshin njerëzit, të cilët ishin detyruar të shisnin pronat e tyre shumë lirë kur janë detyruar të largohen. Gjithashtu, ndryshimet në politikën për

regjistrimin në shkolla dhe për emërimet politike duhej të ndihmonin në rikthimin e një fryme të përgjithshme të barazisë ndër-komunale.

Vulat zyrtare të Serbisë dhe çështje të tjera

3. Gazeta "Politika" shkruan se Kryesia shqyrtoi gjithashtu bashkëpunimin ekonomik midis Kosovës dhe Shqipërisë, aktivitetet e RTV, Prishtinës dhe gazetës "Rilindja" (Gazeta e shqiptarëve të Kosovës) në kohën e aktivitetit kundërrivolucionar si dhe sjelljen e disa organeve të shëndetit publik gjatë demonstratave. Kryesia dënoi keqpërdorimin e stampave dhe vulave zyrtare të Serbisë në Kosovë dhe arriti në konkluzionin se duhej rregulluar menjëherë pozicionin në lidhje me përdorimin e tyre. Në përfundim, Kryesia dha falje për një numër të caktuar të dënuarish me burg (megjithëse është e çuditshme pasi këto falje duhet të njoftohen në një mbledhje që organizohet ekskluzivisht për Kosovën, nuk kemi qenë në gjendje të zbulojmë nëse këto falje zbatohen për kriminelë 'ordinerë' - disa falje janë njoftuar tradicionalisht çdo vit në Ditën e Republikës më 29 nëntor - apo për disa nga demonstruesit e dënuar gjatë verës. Nëse bëhet fjala për këta të fundit, padyshim që do të ishte një zhvillim i rëndësishëm).

4. Siç edhe ndodhi, Kryesia e Kosovës trajtoi menjëherë së paku çështjen e vulave zyrtare të Serbisë më 26 nëntor. Është bërë e njohur se që prej vitit 1973, organet e ndryshme të Kosovës, duke përfshirë Gjykatën e Lartë të Kosovës (!) kanë stampuar dokumente zyrtare në mënyrë të paligjshme me vula ku ishte hequr përmendja e Serbisë. Kryesia e dënoi këtë praktikë dhe vendosi të përgatiste legjislacionin e ri për parandalimin e saj.

Komente

5. Në përpjekje për të shprehur ide, është me vlerë të ritheksoj faktin se çështja e shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova është fshehur qëllimisht prej vitesh (shih për shembull letrën time të datës 29 shtator për Bakallin, paragrafi 7). Fakti që Kryesia serbe është duke folur tani hapazazi për këtë çështje me terma të drejtpërdrejtë, tregon se shqetësimi për këtë problem ka arritur në nivelet më të larta këtu. Dhe kjo jo pa arsye. Një "Kosovë e pastër etnikisht" nuk është pjellë e

imagjinatës së Enver Hoxhës, por një realitet i zhvilluar gradualisht ndërkohë që rritet numri i shqiptarëve dhe serbët largohen. Sidoqoftë, nuk ka një politikë të qartë për të ndaluar këtë proces dhe hapat e sugjeruara deri më tani (të tilla si një skemë e mundshme kompensimi përmendur më lart) duken ose jo-praktike ose pa vend. 'Shtypi i Beogradit' vazhdon t'i japë rëndësi të plotë aspekteve të ndryshme të historisë sëshpërnguljes - por çdokush pyet se mos përpjekjet e tyre mund të kenë ardhur dhjetë vite më vonesë.

I Juaji
Charles Crawford
Oficer Informacioni
Për dijeni: P Rosling Esq
Zagreb
P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-123-

J C R Gray Esq

Ambasada britanike
Beograd
2 dhjetor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Charles,

Kosova

1. Nuk jam i sigurt nëse e keni marrë Përmbledhjen e Çështjeve Ndërkombëtare. Nëse jo, bashkëngjitur po ju dërgoj një kopje të përgjigjes së dhënë nga Dr. Ranko Petkoviç të titulluar "Teza të gabuara" të artikullit në gazetën "The Economist" disa javë më parë, i cili për jugosllavët rezultoi i kundërshtueshëm.

2. Artikulli paraqet zgjidhjen jugosllave të problemit kombëtar që është përpunuar më tej në Platformën për Kosovën.

3. Mendoj që një kopje e artikullit i është dërguar Chris Cviç, por mund t'ia përmendni në rast se ende nuk e ka marrë.

I Juaji,
T. J. Crark

Teza të gabuara

- Kush dëshiron që Kosova të jetë Republikë dhe pse? -
Dr. Ranko Petkoviç

Në një nga botimet e fundit gazeta e Londrës me influence "The Economist", i sugjeron lexuesve të saj të vazhdojnë të ndjekin ngjarjet në Poloni, por të mos harrojnë as ngjarjet në Kosovë, duke nënkuptuar se nuk shihet asnjë arsye përse Kosova nuk mund të ishte Republikë!

Po të mos bëhej fjalë për një gazetë kaq serioze sa ç'është "The Economist" kushdo do të thoshte se nuk është as hera e parë dhe as e fundit që një gazetë nuk arrin të bëjë dallimin e nevojshëm midis së drejtës për të shprehur opinionin e vet mbi çfarë është duke ndodhur në botë dhe detyrës për ta bërë këtë pa ndërhyrë në mënyrën se si i trajton punët e brendshme një shtet sovran.

Për çfarë bëhet fjalë?
Fakt është se nuk ka arsye që të ngrihet ndonjë kundërshtim ndaj "The Economist" apo ndokujt tjetër për faktin se ka treguar



interes për rrethanat në të cilat jeton kombësia shqiptare në Jugosllavi, në rast se kjo kombësi apo ndonjë tjetër në Jugosllavi nuk gëzon të gjitha të drejtat që i përkasin pakicave kombëtare sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në sistemin ligjor dhe politik të Kombeve të Bashkuara (dhe në rastin e Jugosllavisë shumë të drejta të tjera që rrjedhin nga zbatimi i vazhdueshëm i parimit të barazisë së kombeve dhe kombësive dhe nga sistemi i vetë-menaxhimit socialist). Në këtë rast, si gazeta e Londrës "The Economist" dhe kushdo tjetër do të etiketoheshin moralisht dhe politikisht se nxisin respektimin e të drejtave të pakicave të kombësisë shqiptare apo çdo kombësie tjetër në Jugosllavi, njësoj si ne në Jugosllavi mbrojmë respektimin e të drejtave të popujve dhe pakicave kombëtare në vendet ku këto të drejta janë pakësuar për çfarëdo arsye.

Por ky nuk është rasti.

Për të gjithë ata që kanë njohuri mbi rendin kushtetues të Jugosllavisë, dhe veçanërisht ata që mund të kenë mundësinë të vijmë në Jugosllavi dhe të marrin informacione të dorës së parë për statusin real dhe të drejtat e gëzuara nga popujt dhe kombësitë që përbëjnë komunitetin jugosllav, do të jetë e qartë se kombësia shqiptare në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës gëzon një shkallë autonomie, të cilën mund të thuhet me siguri se nuk e gëzon asnjë kombësi tjetër në ndonjë vend tjetër.

Kështu, "The Economist" dhe gazeta të tjera që kanë folur hapur në mënyrë të ngjashme, dhe nuk kanë seli qendrore në Tiranë, kanë vepruar në këtë mënyrë prej rreth një gjysmë shekulli. Konkretisht, shqetësimi i tyre për kombësinë shqiptare në Mbretërinë e atëherëshme të Jugosllavisë në të cilën kjo kombësi nuk kishte të drejta kombëtare njësoj si shumë nga vetë popujt e tjerë jugosllavë, do të kishte qenë tërësisht legjitim, demokratik dhe progresiv dhe në përputhje të plotë me atë që vetë Partia Komuniste e Jugosllavisë e kishte nxitur vazhdimisht në atë kohë: Liri dhe barazi për të gjithë popujt dhe kombësitë e Jugosllavisë.

Por sot, kur si rezultat i arritjeve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe revolucionit socialist, kombësia shqiptare si dhe të gjithë kombësitë e tjera në Jugosllavi jeton në një komunitet të popujve të lirë dhe të barabartë shqetësimi i padëshiruar për statusin dhe të drejtat e saj ka ndodhur ose për shkak të injorancës së plotë ose neglizhencës së fakteve të vërteta ose është motivuar nga interesa të veçanta, ose ndryshe, është pjesë e planit për të destabilizuar Jugosllavinë dhe rajonin e Ballkanit në tërësi. Pra, çështja nuk është se kombësia shqiptare në Kosovë nuk ka të drejta të mjaftueshme, por më tepër është se një rrymë nacionaliste irredentiste, e cila e ka fituar fuqinë kryesisht si rezultat i sjelljes oportuniste të udhëheqjes politike lokale, është e prirë për të zbatuar një plan për të dëmtonuar sovranitetin kombëtar dhe integritetin territorial të tri



Republikave përbërëse të Jugosllavisë, d.m.th., tre shtetet sovraane - Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi, në fazën e parë në të cilën do të krijohet një "Republikë" e cila do të përfshinte "të gjithë shqiptarët" në Jugosllavi; gjithashtu, për të shkelur sovranitetin kombëtar dhe integritetin territorial të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në fazën e dytë në të cilën në një mënyrë a tjetër do të bashkohej me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Në përgjithësi, janë të njohura mënyrat në të cilat shtetet kombëtare janë formuar në Evropë mbi bazën e parimit një komb - një shtet. Si shumë popujt të tjerë evropianë, po kështu edhe sllavët e Jugut bënë një luftë të gjatë për çlirimin e tyre kombëtar, si ata që ishin nën sundimin turk ashtu edhe ata që ishin nën administrimin Austro-Hungarez. Lidhja e tyre etnike dhe ndërgjegjësimi se, duke u bashkuar në një shtet të përbashkët, ata do të ishin në gjendje të ruanin identitetin e tyre kombëtar, çoi në rrethana specifike historike në formimin e Jugosllavisë. Duke pasur një sistem shoqëror borgjez që shtypte liritë shoqërore dhe kombëtare, shteti u copëtua përpara raprezaljeve të ushtrive të Hitlerit, Musolinit, Hortit, Borisit, ballistëve dhe ushtrive të tjera fashiste. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe revolucionit socialist u hodhën themelet e Jugosllavisë së re - një komunitet i përbërë prej popujsh të lirë dhe të barabartë, brenda të cilit janë krijuar republikat ose shtetet e popujve individuale jugosllavë. Të gjitha kombësitë, të cilat në rrethana historike e gjeten veten e tyre brenda kufijve të Jugosllavisë dhe anëtarët e së cilës në mënyrë të ngjashme kanë luftuar për lirinë dhe integritetin territorial të Jugosllavisë - shqiptarë, hungarezë, italianë, slllovakë, çekë, rusë, dhe të tjerë, fituan të gjitha të drejtat socio-politike, ekonomike, kulturore dhe të drejta të tjera që gëzoheshin nga popujt e Jugosllavisë, d.m.th. nga të gjithë qytetarët dhe popullit punonjës i sistemit të vetë-menaxhimit socialist - pa dallim. Për shkak të forcës numerike, kombësia shqiptare mori masën më të madhe të autonomisë brenda shtetit të Serbisë përmes formimit të Krahinës Autonome të Kosovës

dhe Metohisë dhe më vonë Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Për këtë arsye, kërkesa që Kosova të bëhet Republikë nuk është kërkesë as për "të drejta të tjera" apo "autonomi shtesë". Në fakt, bëhet fjalë për një program nacionalist, irredentist, i cili është i papranueshëm jo vetëm sepse është kërkesë absurde nga pikëpamja e historisë, të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të tjera për të pasur shtete paralele të popujve sllavë fqinj të krijuar brenda kufijve të Jugosllavisë, duke kundërshtuar kështu rrugët e historisë dhe themelet e rendit aktual ndërkombëtar, por mbi të gjitha për faktin se është llogaritur qartë që të dëmtohet sovraniteti kombëtar dhe integriteti territorial i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Kështu, pyetja nuk është pse Kosova nuk mund të jetë Republikë, por kush dëshiron që Kosova të jetë Republikë dhe pse. Popujt, territoret kombëtare të të cilëve janë përshtatur nga të tjerët herë pas here kohët e fundit dhe në periudha më të largëta për të përshtatur interesat e tyre dhe të cilët derdhen gjak pafund për të qenë në gjendje që së fundi të jetojnë në komunitetin e shtetit të tyre aktual të popujve dhe kombësive të barabarta, janë të prirë që të jenë të ndjeshëm kur rrezikohet liria, pavarësia, sovraniteti kombëtar dhe integriteti i tyre territorial.

-124-

Konfidenciale

Ambasada britanike
Beograd
7 dhjetor 1981

Kosova Përmbledhje

1. Vlerësim i Platformës së re politike të Komitetit Qendror Jugosllav për të arritur marrëveshje me Krahinën ende të trazuar të Kosovës. Me gjithë përgatitjen intensive, marrëveshja u ra dakord vetëm pas debateve të mprehta, duke treguar se ishte në rrezik jo vetëm e ardhmja e Kosovës por më shumë se kaq (paragrafët 1-4). Platforma

2. Faji kryesor për shpërthimin e nacionalizmit shqiptar qëndron drejtpërdrejt në udhëheqjen e Kosovës, e cila ka ndjekur një politikë të gabuar prej vitesh. Duke ritheksuar me kujdes

politikën e ndriçuar të Jugosllavisë në drejtim të popujve të saj të ndryshëm, Platforma pohonte se nuk kishte arsye legjitime që Kosovarët të kërkonin një afirmim më të madh ndërkombëtar nga sa kishin aktualisht. Koncepti i një Republike të pavarur ishte i papranueshëm. Megjithëse Kosova kishte bërë përpertime të shoqërore, zhvillimi i vendit ishte drejtuar keq. Megjithë dallimet reale ideologjike dhe armiqësinë e vazhdueshme të udhëheqjes shqiptare, Jugosllavia vazhdonte të kërkonte marrëdhënie të balancuar me Shqipërinë (paragrafët 5-9).

3. Platforma përcaktonte udhëzimet për forcimin e sistemit të mbrojtjes lokale dhe ngritjen e punës ideo-politike në mesin e njerëzve; promovimin e zhvillimit përmes investimit më racional, integritet më të madh me ekonominë jugosllave, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e bujqësisë; forcimin e vetë-menaxhimit; inkurajimin e ideve jugosllave në arsim dhe kulturë; si dhe zhvillimin e bashkësisë në mes shqiptarëve dhe popujve të tjerë (paragrafi 10). Perspektivat

4. Autoritetet politike në të gjitha nivelet janë aktualisht të prira për të zbatuar këtë politikë integrimi, por Platforma ka lënë pa zgjidhur disa çështje të rëndësishme. A është Partia në Kosovë në gjendje që të zbatojë politikën e saj në një shoqëri klanore, në të cilën përgjegjësia për gabimet e kaluara politike praktikisht nuk është dënuar? A mundet Partia të ndalojë zhvillimin e një Kosove të pastër etnikisht? Si duhet të zgjidhet marrëdhënia kushtetuese midis Serbisë dhe Kosovës? (paragrafët 11-16). Përmbledhje

5. Çiltërsia e debatit mund të ketë shënuar një hap tjetër përpara në evolucionin demokratik të Jugosllavisë. Politika arrin në ripohimin e vetë-menaxhimit si zgjidhje e çështjes kombëtare. Në aspektin afatshkurtër, masat pozitive të propozuara do të inkurajojnë integrimin dhe Partia dhe Forcat e Armatosura duhet të jenë në gjendje që të mbajnë situatën nën kontroll. Në aspektin afatgjatë, mbetet çështje e hapur nëse nacionalizmi shqiptar do të mund të frenohet dhe shmanget me sukses (paragrafët 17-18).

-125-

Konfidenciale

RT. Hon Lordi Carrington KCMG
MC
Ambasada britanike
Beograd
17 dhjetor 1981
Zyra e Jashtme dhe e
Komonuelthit
Londër SW
Shkëlqesia Juaj,

Çështja e Kosovës

1. Në njoftimet e mia të datës 24 prill dhe 1 korrik, kam shqyrtuar trazirat në Kosovë në pranverë dhe përpjekjet e autoriteteve për të vënë situatën nën kontroll. Gjithashtu kam vlerësuar implikimet e këtyre ngjarjeve për Jugosllavinë në përgjithësi. Megjithëse rivendosi e rendit, problemi themelor i nacionalizmit shqiptar ende qëndron. Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (KQ LKJ) u mblodh më 17 nëntor për të arritur një marrëveshje mbi politikën që duhej ndjekur për trajtimin e problemit dhe më pas botoi një Platformë e cila aktualisht përshkruhet si historike. Më poshtë vlerësoj këtë Platformë dhe perspektivat për arritjen e qëllimeve që ajo ka përcaktuar. Historiku

2. Muajt e verës ishin një periudhë aktiviteti të pazakonshëm në Kosovë dhe Beograd. Nën presion të vazhdueshëm nga Federata, autoritetet në Kosovë ishin të shtrenguara të mermin masa në tre fronte kryesore: të spastronin udhëheqësit / zyrtarët, akademikët, studentët dhe gazetarët përgjegjës, të cilët ishin identifikuar me nacionalizmin shqiptar; të dënonin shpesh me dënime jashtëzakonisht të rënda ata që ishin përfshirë drejtpërdrejt në trazira; të ndërmerrnin një shqyrtim të plotë të zhvillimit politik, shoqëror dhe ekonomik të Krahinës. Lajmet mbi ecurinë e kësaj pune janë theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga raportet e shtypit mbi aktivitetin nacionalist në forma të ndryshme: letra anonime, parulla armiqësore, kërcënime, dëmtimi i pasurisë, sabotimi dhe dhuna fizike. Ndërkohë, megjithë përpjekjet zyrtare për kontrollin e eksodit, ky eksod i sllavëve etnikë d.m.th. serbëve dhe malazezëve vazhdoi pa ndërprerje. Ndërkohë, Shqipëria vazhdoi presionin psikologjik drejtpërdrejt përmes propagandës së saj, që arriti kulmin në mbështetjen e fortë të Enver Hoxhës për kauzën e shqiptarëve të Kosovës në Kongresin e Partisë Shqiptare në nëntor, dhe indirekt përmes veprimeve të emigrantëve shqiptarë kundër institucioneve jugosllave dhe zyrtarëve në Evropë.

3. Ky aktivitet u pasqyrua në Beograd, ku autoritetet federale dhe serbe u ndeshën me aspektet më të gjera të problemit. Ndërkohë që këto të fundit punojnë për të ripohuar autoritetin e tyre kushtetues mbi të gjithë krahinën e Serbisë, d.m.th., duke përfshirë dy Krahinat Autonome, Federata u angazhua në nivel ndërkombëtar për të luftuar irredentizmin shqiptar dhe në nivel vendor për



të rivlerësuar të ardhmen e Kosovës.

4. Siç më tregoi një prej anëtarëve të saj, Komiteti Special i ngritur nga KQ i LKJ kishte punuar në mënyrë intensive prej muajsh për të përgatitur projekt-Platformën që iu paraqiti Komitetit Qendror më 17 nëntor. Pas pesë shqyrtimeve, rezultati ishte padyshim një dokument i përpunuar në mënyrë të detajuar. Për këtë arsye është edhe më e çuditshme që Mbledhja e mbajtur për të dhënë miratimin formal shkaktoi një debat kaq të nxehtë sa që Komiteti ishte i detyruar të hartonte përsëri disa pjesë të këtij dokumenti. Megjithatë, një pjesë e debatit u shfaq në mënyrë të pazakontë në televizion dhe u publikua në shtyp, ne nuk mund të dallojmë sesa pjesë të versionit original pësunan ndryshime, por argumentet nga baza treguan se rrezikohej më shumë se thjesht e ardhmja e Kosovës.

Platforma të përgjithshme
5. Pas shqyrtimit me hollësi të faktorëve përkatës ndërkombëtare dhe të brendshëm, platforma bëri pyetjen thelbësore sesi mund të kenë ndodhur ngjarjet në Kosovë. Ajo dha pesë përgjigje. Së pari, forcat gjithnjë të pranishme nacionaliste në Jugosllavi ishin inkurajuar nga vështirësitë ekonomike të vendit dhe vdekja e Titos. Së dyti, udhëheqja e Kosovës, e motivuar nga ambicie jo realiste për zhvillimin e Kosovës përmes kërkesave të tepërta për burimet e pjesës tjetër të vendit, nxitte pakënaqësi në radhët e popullit dhe i dha nacionalistëve hapësirë për të manovruar. Së treti, ndryshimet e shpejta shoqërore dhe zgjerimi i arsimit, duke sjellë pakënaqësi dhe papunësi serioze veçanërisht në mesin e të rinjve, ishin vlerësuar gabimisht nga udhëheqja e Kosovës, pjesërisht për arsye se vetë ajo ishte molepsur nga ndjenja e nacionalizmit. Së katërti, izolacionizmi ekonomik dhe politik i Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia në përgjithësi inkurajuan konceptin "Kosova - Republikë". Dhe, së pesti, udhëheqja e Kosovës veproni në mënyrë autarkike, duke shpërfillur parimet e vetë-menaxhimit dhe duke lejuar vlerësimin e nepotizmit. Shkurtimisht, Komiteti Qendror e vuri fajin kryesor ndaj udhëheqjes

së Kosovës me argumentin se kishte ndjekur një politikë të gabuar prej vitësh, megjithatë e pranoi por vetëm në mënyrë kalimtare se udhëheqja e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe Jugosllavisë ishte gjithashtu gabim pasi kishte dështuar për të kuptuar më herët atë që po ndodhte.

Çështja kombëtare

6. Platforma bëri të ditur se nacionalizmi ishte thelbi i problemit të Kosovës. Ai filloi nga pozita komuniste ortodokse se çdo komb ka të drejtën e vetëvendosjes, duke përfshirë të drejtën për t'u shkëputur ose (kontraktore dhe sipas teorisë komuniste, eprorë) të drejtën për t'u bashkuar me Kombet e tjera. Platforma më tej vazhdoi me përshtatjen e teorisë për kushtet Jugosllave, forcimin e elementit të kësaj të fundit, duke deklaruar se guri i dytë i themelit për Jugosllavinë e re ishte parimi i unitetit politik, pavarësia dhe integriteti territorial i Shtetit Federal jugosllav. Njerëz të ndryshëm në Kosovë kishin zgjedhur lirisht që të jetonin në Serbi dhe Jugosllavi, por duke pasur parasysh disa karakteristika historike, kulturore dhe gjuhësore, për ta ishte krijuar një krahinë autonome. Asnjëherë nuk ishte shtruar çështja për të pranuar një republikë shqiptare brenda federatës sepse teoria jugosllave ishte, siç ishte ritheksuar në Platformë, që shqiptarët në Kosovë ishin vetëm një "kombësi" (d.m.th. pakicë kombëtare) dhe për rrjedhojë nuk cilësoheshin ashtu si "kombet" për statusin e Republikës. Megjithatë, zhvillimi i vetë-menaxhimit socialist në Jugosllavi kishte forcuar më tej barazinë kombëtare: të gjitha komunitetet kombëtare, duke qenë në gjendje të dispononin "të ardhura kombëtare nga puna e tyre", kishin fituar të drejtën për të vendosur vetë kushtetutat, ligjet dhe institucionet në Krahinat e Republikat e tyre dhe në nivel federal. Platforma pretendonte se kjo shkallë e barazisë kombëtare, "përfaqësonte arritjen më të lartë të praktikës shoqërore dhe garancive ligjore kushtetuese të njohura në botë sot"! Kështu, në të vërtetë, Platforma pohoi se meqenëse vetë-menaxhimi po zbatohet gjithnjë e më shumë, shqiptarët në Kosovë gëzonin masën më të plotë të mundshme

të vetëvendosjes. Një trajtim i tillë e mundësonte Platformën që të dënonte "nacionalizmin" shqiptar dhe të pohonte se "afirmimi kombëtar", i cili ishte i pranueshëm, mund të shprehej brenda formave aktuale kushtetuese, ekonomike dhe shoqërore. Në të vërtetë sipas Platformës, nuk kishte arsye legjitime që shqiptarët në Kosovë të kërkonin me shumë.

7. Sidoqoftë, Platforma pranoi se ishte lejuar që në Kosovë të zhvillohej një praktikë politike, e cila e pengonte Serbinë së bashku me organizatat federative socio-politike që të ushtronte përgjegjësinë e saj për "tërë zhvillimin shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor të Republikës në tërësi dhe të të gjitha pjesëve të saj, duke përfshirë Kosovën". Brenda kësaj tendence drejt izolacionizmit, ishte krijuar koncepti "Kosova - Republikë", i inkurajuar nga personalitetet e larta në Kosovë, me qëllim ngritjen e një shteti më vete stalinist dhe të pastër etnikisht. Një gjë e tillë do të kërcënonte sistemin e vetë-menaxhimit dhe integritetit territorial të Jugosllavisë në shkëlqej të parimeve të paprekshmërisë territoriale të mishëruar në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Aktin Final të Helsinkit.

Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik
8. Platforma i përshkroi përparimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike të bëra në Kosovë kryesisht me ndihmën e fondeve federale dhe perspektivat për ndihmë edhe më të madhe në Planin aktual 5-vjeçar. Problemi qëndronte në vetë konceptin e zhvillimit, i cili kishte qenë: "i njëanshëm", duke u përqëndruar në disa projekte nxjerrëse, në shkallë të gjerë dhe që kërkonin investimin e një kapitali të madh; "i pamjaftueshëm", duke neglizhuar bujqësinë dhe industrinë përpunuese; dhe "i paorganizuar", duke ofruar shumë pak punë për një numër të madh të rinjsh, të papërgatitur nga sistemi arsimor për punë brenda ose jashtë Krahinës. Tani kërkohej një riorientim i plotë. Marrëdhëniet me Shqipërinë
9. Duke shprehur me forcë se Jugosllavia nuk kishte pretendime ekstra-territoriale dhe kishte ndjekur vazhdimisht një politikë të fqinjësisë së mirë, megjithë dallimet reale ideologjike me

Shqipërinë, Platforma shënoi armiqësinë e pandërprerë të udhëheqjes shqiptare dhe ndërhyrjen në punët e brendshme të Jugosllavisë, evidentuar nga mbështetja e hapur për nacionalistët në pranverë. Megjithatë, Jugosllavia vazhdoi të favorizonte bashkëpunimin e arsyeshëm dhe të ekuilibruar me Shqipërinë, pavarësisht nga dallimet, për të cilin kushtet minimale ishin respektimi korrekt për bashkëpunim të barabartë, për sovranitetin dhe kufijtë e Jugosllavisë dhe për t'i dhënë fund ndërhyrjes në punët e brendshme të saj. Ballkani nuk duhet lejuar që të bëhet një zonë konfliktesh për shkak të "planeve irredentiste megalomane të udhëheqjes shqiptare", por, nëse është e nevojshme, Jugosllavia do të mbrojë çdo pëllëmbë të territorit të saj. Platforma theksoi rolin negativ të Enver Hoxhës, duke i dhënë shpresë kështu pasuesve eventuale të tij mbi perspektivën e përmirësimit të marrëdhënieve nëse ata do të braktisnin pretendimet e tij të "Shqipërisë së Madhe".

Udhëzime

10. Në seksionin përmblyllës, Platforma renditi një seri udhëzimesh të politikave për të ardhmen:

(a) Situata politike dhe e sigurisë kërkonte forcimin e sistemit të mbrojtjes së të gjithë njerëzve dhe vetë-mbrojtjen shoqërore si dhe përmirësimin e besimit reciprok dhe bashkësisë midis popullit dhe Forcave të Armatosura, që nacionalistët po përpiqeshin t'i shkelnin. Nevojitej që Lidhja e Komunistëve dhe organizatat e tjera socio-politike të organizonin punë të gjerë politike dhe ideologjike, veçanërisht në radhët e të rinjve dhe inteligjencës për të eliminuar nacionalizmin.

(b) Zhvillimi ekonomik kërkonte një plan afat-gjatë, në të cilin Serbia, Republikat e tjera dhe Vojvodina do të shqyrtonin me Kosovën investimin e fondeve që ato dhe Federata ishin zotuar të jepnin (llogaritur në vlerën 2,000 milion £ për periudhën 1981-5). Në kundërshtim me praktikën e kaluar ku 90 % e fondeve për investim vinin nga Federata dhe kreditë e jashtme drejtoheshin për qeverinë e Kosovës u propozua që në të ardhmen firmat jashtë Kosovës të shoqëroheshin me firmat lokale, për të siguruar 50 % të kapitalit vetë ndërkohë që gjysma tjetër do të kontribuohet nga Federata. Perspektivat e punësimit do të rriteshin sepse shumë nga projektet e mëparshme të zhvillimit po i afroheshin tashmë përfundimit por nevojiteshin industri të reja që kërkonin shumë krahë pune dhe një politikë e tillë arsimore që do t'i bënte të rinjtë të lëviznin më shumë. Bujqësia duhej të modernizohej dhe të bëhej më produktive duke i lidhur fermerët privatë me sektorin social.

(c) Vetë-menaxhimi nevojitet që të zhvillohej për të parandaluar abuzimin e pushtetit personal dhe për të lehtësuar pjesëmarrje më të madhe të shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Kosovës në vendimmarrje në të gjitha nivelet brenda Krahinës, Republikës dhe Federatës, gjë që do të garantonte

rritjen e shkallës së cilësisë së tyre me të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë.

(d) Arsimi, kultura, shkencat dhe informacioni nevojitej që të analizoheshin dhe të bëheshin ndryshime për të penguar indoktrinimin nacionalist të të rinjve. U shtua një notë jugosllave me thirrjen që të gjithë punëtorët të ushqenin jo vetëm karakteristika kombëtare por edhe idetë e përbashkëta që ekzistonin në të gjithë Federatën.

(e) Afirmimi i kombësisë shqiptare nuk duhet të lejohet që të abuzohet nga nacionalistët. Nuk do të arrihej ndonjë gjë e madhe duke denoncuar nacionalizmin: ajo që nevojitej ishte mirëkuptimi i vërtetë, simpatia dhe barazia, bashkësia dhe shprehja e të drejtave dhe aspiratave të individëve dhe komuniteteve nacionale. Duhej goditur nacionalizmi i çdo lloji nëse duhej të zgjidhej situata në Kosovë.

Perspektivat

11. Sipas parimit të centralizmit demokratik, kjo deklaratë politike bëhet tashmë e detyrueshme për të gjithë komunistët. Komiteti krahinor i Kosovës do të mblidhet nga mesi i dhjetorit për të shqyrtuar zbatimin e kësaj deklarate brenda Krahinës, por ka shenja se aksioni ka filluar. Për këtë arsye, mund të parashikojmë se do të vazhdojnë përpjekje të vendosura nga autoritetet në të gjitha nivelet përmes politikës së kulaçit dhe kërcënit, duke inkurajuar zhvillimin ekonomik me ndihma bujare dhe duke u marrë pa kompromis me aktivitetet nacionaliste, me qëllim përshpejtimin e integritetit të Kosovës në komunitetin e gjerë jugosllav. Bazuar në një platformë të tillë, perspektivat mund të vlerësohen se janë më të mira se asnjëherë. Por, platforma lë pa përgjigje një numër të rëndësishëm çështjesh të cilat, nëse nuk zgjidhen do të jepnin një panoramë më pak optimiste. Disa nga këto çështje u paraqitën nga baza në një debat për platformën. 12. Në platformë nuk gjendet asnjë fjalë kritike mbi rolin e popullit punonjës në Kosovë. Faji i është vënë udhëheqjes lokale, intelektualëve, studentëve dhe fëmijëve të shkollave. Por, e dimë se disa punëtorë fabrikash janë përfshirë në demonstratë dhe dimë gjithashtu faktin e thjeshtë se nacionalistët vazhdojnë të vepronin në fshatra, të cilat ofronin një shkallë bashkëpunimi, nëse jo mbështetje të menjëhershme nga punëtorët e fermave. Platforma parashikon një fushatë të gjerë "për të fituar mbështetje të plotë" por Partia përballet hapur me një detyrë të madhe për të cilën do të nevojitet kohë. Kjo situatë ngre dy pyetje të tjera – sa e fortë është Partia dhe sa kohë ka ajo?

13. Siç tregon Platforma dhe ngjarjet e muajve të fundit, Kosova është drejtuar nga një numër i vogël klanesh të lidhura ngushtë, që vepronin në mënyrë arbitrare jashtë politikës partiake. Spastrimi i bërë largoi shumë nga anëtarët e tyre, por duke pasur parasysh mungesën e entuziazmit të treguar në ndjekjen e tyre ka të ngjarë që influenca e tyre ende vazhdon. Për më tepër, Partia ka

synuar të jetë më së shumti urbane në një krahinë kryesisht rurale dhe komunistët e brezit të parë të përkushtuar ishin kryesisht serbë dhe malazezë, të cilët aktualisht përbëjnë një pjesë të pakësuar të popullsisë.

14. Sidoqoftë, vihet në dyshim nëse koha është në avantazhin e autoriteteve. Faktorët e kombinuar të normës së lartë të lindjeve në mesin e shqiptarëve dhe migrimi i sllavëve drejtuar në pjesë të tjera të Jugosllavisë ndoshta do të rezultojnë në një enklavë etnikisht të pastër në Serbi në të ardhmen e parashikueshme, duke bërë që statusi i Kosovës të duket gjithnjë e më shumë i palogjikshëm. Vlen të përmendet se u braktis me nxitim përpjekja e bërë nga baza për të përfshirë kontrollin e lindjeve në platformë si diçka diskriminuose dhe se Platforma është po ashtu e heshtar lidhur me faktin se si të ndalohet eksodi, përveç nëpërmjet inkurajimit të bashkimit.

15. Platforma shmangu gjithashtu përcaktimin e limiteve të përgjegjësisë për atë që ka ndodhur. Ajo ia vuri fajin kryesor udhëheqjes së Kosovës, megjithëse nënkuptonte se Lidhja e Komunistëve në tërësi ka gjithashtu pjesën e vet të fajit, pasi nuk ndërhyri më shpejt. Sidoqoftë, autoritetet qendrore nuk janë ende të gatshme për këtë lloj kritike, megjithëse të paktën një folës në debat aludoi hapur për këtë dhe zëdhënësi i Ushtrisë tha para Komitetit Qendror haptazi se autoritetet politike në të gjitha nivelet kishin qenë jokompetente dhe joefikase në trajtimin e pasojave të situatës në Kosovë.

16. Për më tepër, Platforma nuk arriti të hidhte dritë mbi pyetjen e vështirë të marrëdhënies kushtetuese midis Serbisë dhe krahinave autonome, gjë të cilën e kam përsëritur në njoftimin tim të dërguar më 24 prill. Platforma nuk lëshon pe nga qëndrimi zyrtar se populli i Kosovës ka zgjedhur lirisht të jetojë brenda Serbisë; se, me zhvillimin më të plotë të vetëmenaxhimit, ata do të arrijnë "një shkallë më të madhe komuniteti" brenda krahinës, Republikës, dhe si pjesë e Federatës; dhe se Kosova duhet të mbetet brenda kuadrat kushtetues të Serbisë dhe Federatës. Platforma është tejet këmbëngulëse për respektimin e duhur të të drejtave të Serbisë dhe siç tregoi një ndërhyrje e fuqishme nga baza, kjo situatë ka alarmuar Krahinën tjetër të Vojvodinës, e cila është e shqetësuar që të mos humbasë pavarësinë e saj të fituar me qetësi për shkak të vullit të Kosovareve. Është e qartë gjithashtu nga treguesit në forumet e tjera se Vojvodina po ndjek një politikë jobashkëpunuese, ku nga Serbia po bëhen përpjekje për të shpallur të drejtat e saj kushtetuese. Kështu, ndërkohë që Serbia për momentin mund të shtrëngojë sundimin e saj ndaj Kosovës, do t'i duhet që të ecë me kujdes për të shmangur tjetërsimin e Vojvodinës se mos spektri i nacionalizmit serb mund të bëhet shqetësues për të gjithë.

Përmbledhje
17. Platforma u debatua në Komitetin Qendror në një

atmosferë të pashembull diskutimi të sinqertë, pjesa më e madhe e të cilit siç kam vënë në dukje i është përcjellë publikut të gjerë. Në vetvete ky aspekt është inkurajues për ngjarjet në Kosovë, që mund të shënojnë një hap tjetër përpara drejt zhvillimit të Jugosllavisë për një shoqëri më shumë demokratike.

18. Megjithatë, vizioni i Platformës për të ardhmen e Kosovës tregon se ka limite për një zhvillim të tillë. Kjo sepse nga sistemi i vetë-menaxhimit socialist të Jugosllavisë (i cili mbulon politikën dhe ekonominë dhe mirëpret ndryshimet) duket se rezultojnë që, nëse Kosova e dëshiron një gjë të tillë, duhet t'i jepet statusi i Republikës; Sidoqoftë, Platforma përsërit me forcë se Kosova duhet të mbetet Krahinë brenda Republikës së Serbisë. Në mënyrë të ngjashme, Partia vazhdon të besojë se zhvillimi i vetë-menaxhimit dhe kapërcimi i barrierave të gjuhës, zakoneve, prapambetjes shoqërore dhe ekonomike do të bëjë të mundur që të integrohet një Kosovë e kënaqur në komunitetin e popujve jugosllavë. Padyshim, në aspektin afatshkurtër, këto masa pozitive do të inkurajojnë rritjen e bashkëpunimit dhe riphohimin aktual të kontrollit qendror të Partisë; gjithashtu përdorimi i forcave të mjaftueshme të sigurisë në Krahinë duhet të pengojë zhvillimin e trazirave të tjera serioze. Por, në aspektin afatgjatë, unë mund të bie dakord me vetë platformën kur shpreh:

"Ngjarjet në Kosovë përbëjnë një paralajmërim tjetër për LKJ se nacionalizmi gjithmonë mohon revolucionin socialist dhe e rrezikon atë".

Lufta për të përmbajtur dhe shmangur nacionalizmin shqiptar në Kosovë do të jetë e gjatë dhe jo domosdoshmërisht e suksesshme. Mund të ndodhë që vetëmenaxhimi të mos jetë zgjidhja e duhur.

19 Bashkangjitur po ju dërgoj një kopje të këtij njoftimi për Përfaqësuesit e Madhërisë së Saj në Athinë, Bon, Bukuresht, Budapest, Moskë, Paris, Romë, Sofie, Uashington, Përfaqësuesin e Përhershëm të Britanisë së Madhe pranë Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Konsullin e Përgjithshëm të Madhërisë së saj në Zagreb.

Mbetem i Juaji Besnikërisht
E. Bolland

-126-

Konfidenciale

Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
Ambasada Britanike
Beograd
7 dhjetor 1981
Londër SW1A 2AH
H E Z. E Bolland KCMG

Vizita e profesor Radogan Vukadinoviq në Mbretërinë e Bashkuar

1. Meqenëse Nigel Broomfield ishte i angazhuar tjetërkund, unë ftova Vukadinoviqin për të drekuar të Premten në Athenaeum. Fatkeqësisht dreka jonë ishte shumë më e shkurtër sesa e dëshironim të dy meqenëse unë

kisha një takim në spital atë pasdite. Por meqenëse Vukadinoviq ishte i lirë atë mbrëmje, e ftova në shtëpi për darkë. Ai dëshmoi se ishte një i ftuar mirënjohës dhe bashkëbisedues interesant.

2. Siç mund ta dini, Vukadinoviq po punon mbi zhvillimet në marrëdhëniet Lindje-Perëndim për periudhën midis fundit të Luftës së Ftohtë dhe 'detantës'. Ai tha se të dhënat e vëna në dispozicion nga IISS e kishin ndihmuar shumë.

3. Vukadinoviq dëshironte gjithashtu për të folur rreth gjendjes aktuale të marrëdhënieve Lindje-Perëndim. Mjaftonte ta nxisje shumë pak që ai të fliste mbi zhvillimet në Jugosllavi. Bashkëngjitur po ju dërgoj një njoftim për pikat kryesore që ai diskutoi, ku shpjegoi se ishte në gjendje të ndiqte hap pas hapi zhvillimet në Kosovë, megjithëse studentët shqiptarë nga Kosova që ndjekin kurse pasuniversitare janë në fakultetin e tij.

4. Vukadinoviq foli me entuziazëm për vizitën tuaj të fundit në Zagreb (ai tregoi me kënaqësi se si një koleg nga Beogradi ishte habitur për faktin që ai nuk ishte ndërjeri i detyruar të kërkonte certifikatë sigurie për vizitën tuaj në fakultetin e tij). Gjithashtu, ishte e qartë se ai pëlqen dhe vlerëson lidhjet e tij me Peter Rosling në Zagreb.

5. Kur po flisnim për ndikimin e problemeve ekonomike të Jugosllavisë në Unionsitetin e tij, Vukadinoviq tha se një problem madhor përbënte shkurtimi i fondeve për vizitat e punës jashtë vendit. Doli se nevoja e tij kryesore është për ftesa që mbulojnë jetesën e tij jashtë vendit. Fluturimet për JAT mund të paguhen në dinarë, dhe ky fakt përbën problemin më të vogël.

6. Vukadinoviq pret që të kthehet këtu në mars. Ai tha se do të donte të takojë përsëri me mua deri atëherë. Jam mirënjohës nëse Peter do të më njoftonte për datat e vizitës së tij në kohën e duhur.

G S Barras
Stafi i Planifikimit
K 115
Për dijeni: P E Rosling Esq, Zagreb
N. Broomfield, EESD

-127-

Centralizmi kundrejt decentralizmit

1. Për njëfarë kohe, nuk ka shumë shpresë që të shohim një udhëheqje më të fortë. Ndërkohë, perspektivat për përpjekje bashkëpunimi të tilla si Komisioni i Kraiger, nuk janë të mira.

2. Periudha parazgjedhore për zgjedhjet Shtetërore dhe Partiake vitin e ardhshëm ka vështirësuar marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve. Por edhe pas zgjedhjeve nuk ka gjasa të ekzistojë një ndjenjë e mjaftueshme urgjence për të zgjidhur disa prej çështjeve të rëndësishme të kontrollit në nivel republikan kundrejt kontrollit qendror.

3. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në konferencën e ekonomistëve jugosllavë në Opatia (16/17 nëntor) ishin tepër pesimistë për perspektivat ekonomike të Jugosllavisë dhe barrën e borxhit të Jugosllavisë.

Sidoqoftë, nuk dukej ende se politikanët dëshironin apo ishin në gjendje të merrnin vendimet e nevojshme.

4. Një prej çështjeve qendrore që duhet zgjidhur është baza mbi të cilën do të përdoret monedha e fortë dhe limitet e monedhës së fortë që do të huazohet nga republikat individuale. Sistemi aktual është qesharak (për shembull, është në interesin e Sllovenisë që t'i shesë letër dhe energji Austrisë dhe jo Kroacisë, megjithëse Kroacisë i duhet të blejë letër dhe energji sërish nga Austria me një çmim më të lartë në monedhën e fortë).

5. Me gjithë problemet ekonomike, nuk ka të ngjarë që të shfaqet versioni jugosllav i sindikatës Solidariteti. Punëtorët e një republike nuk kanë ndonjë simpati për ato të një republike tjetër. Më e rëndësishmja, sistemi i vetë-menaxhimit ka bërë që kategoritë e ndryshme të punëtorëve në fabrika të kenë pak simpati për njëra-tjetrën. Deri më sot janë zhvilluar disa greva në Kroaci, por në asnjërin prej tyre nuk kanë marrë pjesë më shumë se një grup punëtorësh. Asnjë nga fabrikat nuk ka ndërprerë punën plotësisht.

6. Një kërcënim më serioz për partinë vjen nga klasa e mesme. Rritja ekonomike dhe udhëtimet jashtë vendit e kanë mbajtur atë në gjendje të fjetur. Partia do të bënte një gabim të rëndë nëse do të përpqej përmes kontrollit të valutës dhe kontrolleve të tjera të kufizonte më tej udhëtimet e tyre jashtë vendit (apo udhëtimet e ndokujt tjetër). Jo çdokush udhëtonte jashtë vendit, por njerëzit besonin se e drejta për ta bërë këtë ishte e rëndësishme për ta.

7. Problemet ekonomike të Jugosllavisë kanë inkurajuar disa studentë Universiteti që të ekzagjerojnë avantazhet e socializmit të Evropës Lindore. Pretendimet për punësim të plotë dhe vizitat e shkurtra në Hungari me kurse të favorshme këmbimi, prej tyre ose miqve të tyre, i kishte bërë ata të mendonin se jeta në vendet socialiste kishte vërtetë diçka për ta lavdëruar. Gjithsesi, jo shumë njerëz mendonin në këtë mënyrë. Por të rinjtë në Jugosllavi nuk e kishin pasur një opinion të tillë prej dekadash.

8. Bashkimi Sovjetik nuk po përpqej që të impononte ritmin e marrëdhënieve të tij me Jugosllavinë (pjesërisht për faktin se perspektivat për marrëdhënie me Shqipërinë dukeshin më të mira - shih më poshtë). Megjithatë, pritet së shpejti një vizitë në Beograd e një udhëheqësi sovjetik, me gjasa Tikhonov. Kosova

9. Situata në Kosovë është e keqe. Për shumë vite që do të vijnë Kosova do të jetë "Provincë e Jugosllavisë" (Ulster).

10. Në Serbi dhe Maqedoni (në Bosnje dhe Mal të Zi gjithashtu) ekzistonte një mosbesim i thellë për nacionalizmin shqiptar. Kishte pikëpamje që ndryshonin lidhur me faktin nëse Kosova do të ishte forca shtytëse për një Shqipëri të re dhe të madhe (si Piemont në krijimin e Italisë), apo nëse do të kërkonte integrimin e saj me Shqipërinë aktuale. Sidoqoftë, një gjë është e qartë - shqiptarët e

Kosovës janë "jo-jugosllavë për nga botëkuptimi". Nuk ekzistonte perspektiva që statusi i Kosovës brenda Serbisë të mund të ndryshohej për një kohë të gjatë në të ardhmen.

11. Për të ardhmen e parashikueshme nuk ka perspektivë se shqiptarët e Kosovës do të ofrojnë një udhëheqje efektive partiake në krahinë. Vetëm pak njerëz ishin të gatshëm t'i shërbenin Partisë "në interes të Jugosllavisë". Vetëm një grup i vogël shqiptarësh i Partisë së Kosovës shprehte gjëra që mund të citoreshin në shtyp. Pjesa tjetër e partisë ndiqnin një politikë të rezistencës pasive.

12. Aktualisht vetëm 200,000 njerëz (prej popullsisë 1.5 milionë) ishin të punësuar rregullisht; 300,000 njerëz ishin të papunë dhe 450,000 ishin në shkollë dhe Universitet. Në të kaluarën udhëheqja e Partisë së Kosovës kishte qenë në gjendje të ruante pamjen e kontrollit përmes lëvrimin të shumave të konsiderueshme të financave federale. Klasa e mesme kishte përfutur shumë nga përmirësimi i lehtësirave kulturore/arsimore dhe nga përfutimet që rridhnin prej projekteve të ndërimit.



13. Rëniet dhe uljet aktuale në investimet në Kosovë kishin vënë nacionalizmin shqiptar në plan të parë në Kosovë. Në fillim të viteve 1970, klasa e mesme kroate kishte preferuar të kufizonte ndjenjat e saj nacionaliste dhe jo të përballje me rrënuja politike që kërcënonin mirëqenien e tyre. Situata në Kosovë është ndryshe. Nacionalizmi është më i fortë dhe madje edhe në rrethana të vështira klasa e mesme mjaft e vogël në numër mund ta përballojë mjaft mirë situatën.

14. Vështirësitë aktuale u shoqëruan me eksodin e serbëve dhe "jugosllavëve" të tjerë nga Kosova. Ka shumë pak shpresë që të vërshojë rritja e ndihmës ekonomike në Kosovë, megjithëse disa nga fondet mund të investohen në mënyrë më produktive. Kontrolli do të duhet të ushtrohet nga policia dhe ushtria dhe jo me mjete politike. Shqipëria

15. Karakteristika kryesore e politikës së jashtme të Shqipërisë është se ajo ka preferuar të jetë miqësore me ato vende me të cilat Jugosllavia ka marrëdhënie të dobëta. Shqipëria ka qenë shumë e afërt me Kinën deri kur u përmirësuan marrëdhëniet mes Kinës dhe Jugosllavisë.

16. Ky faktor si dhe struktura dhe traditat e Partisë Komuniste Shqiptare theksuan afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, nëse jo më parë, atëherë pas vdekjes së Hoxhës.

17. Zyrtarët e MPJ të Jugosllavisë pretendojnë se janë në dijeni që Bashkimi Sovjetik i ka thënë aleatëve të saj të Paktit të Varshavës që të bëjnë përpjekje të veçanta për të plotësuar kërkesat shqiptare për pjesë këmbimi industriale/ushtarake dhe këtë ta bënin me çmime favorizuese. Bashkimi Sovjetik do të paguante diferencën. Tregtia e Shqipërisë me Hungarinë dhe disa vende të tjera të Evropës Lindore është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit apo më shumë.



Xhaka: Synojmë të fitojmë edhe dy trofetë e tjerë

LEVERKUSEN, 15 PRILL - Bayer Leverkusen fitoi kampionatin gjerman për herë të parë në 120 vjet histori të klubit. Mesfushori nga Kosova, Granit Xhaka, ka qenë një nga më të mirët në fushë në ndeshjen që i dha titullin Bayer Leverkusenisit, ku shënoi një gol të jashtëzakonshëm në fitoren 5-0

ndaj Werder Bremenit. 31-vjeçari tha se të bëhesh kampion gjerman për herë të parë ishte ëndërr. "Është e vështirë të gesh fjalët e duhura për t'i përmbledhur emocionet që kam. Të rikthehem pas sezonit tim të parë në ligë është e pabesueshme. Ne patëm një sezon të mrekullueshëm, një

lojë të shkëlqyer, jo pjesën e parë, por pjesën e dytë që bëjmë mirë. Tani kënaqemi", ka thënë Xhaka.

Por prishtinasi nuk ngopet vetëm me titullin e kampionit në Gjermani, pasi ai kërkon edhe Kupën e Gjermanisë, ku në finale janë me Kaiserslauternin si dhe Evropa Ligën. Ai u ka bërë

një premtim të madh tifozëve të klubit gjerman se do të tentojnë t'i sjellin në shtëpi edhe dy trofe të tjerë. "Kur gjuan një top në moshë të re ëndërron momente të tilla. Ishte punë e vështirë ditaditës, me të gjithë ata që u përfshinë në këtë klub. Në karrierën time 14-vjeçare futbollistike është e veçantë për



mua, por edhe më shumë. Është më e veçantë për këtë klub. Tani duam më shumë dhe të marrim edhe trofe të tjerë", ka shtuar Xhaka.

Sonte mësohen dy gjysmëfinalistët e parë në Ligën e Kampionëve

"Epoka e re"

BARCELONË, 15 PRILL - Skuadra e Barcelonës synon të kualifikohet në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve për herë të parë që nga sezoni 2018-19. Sonte (e martë) pret Paris Saint-Germainin. Skuadra e drejtuar nga Xavi Hernandez hyn në këtë ndeshje me optimizëm për kualifikim, pasi në ndeshjen e parë mori një rezultat të mirë duke fituar në kryeqytetin francez me rezultat 2-3. "Të shkosh në gjysmëfinale do të ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Ta shohësh Barcelonën si kjo është tashmë një sukses, por qëllimi është të shkosh në gjysmëfinale dhe do të ishte shumë emocionuese. Aspekti emocional është thelbësor në garat e eliminimit. Jam mirë. Jam i motivuar për këtë ndeshje. Duhet të tregojmë shumë personalitet për të kaluar

në gjysmëfinale. Do të jetë një PSG e guximshme dhe do të kemi një avantazh, duke luajtur në shtëpi, por do të jetë një ndeshje shumë e vështirë. Jemi të emocionuar në kuptimin e mirë të fjalës", ka thënë trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez. Prej se trajneri Xavi njoftoi se do të largohet në verë, forma e Barcelonës ka qenë e shkëlqyer, duke kaluar 13 ndeshje pa humbje në të gjitha garat, me 10 fitore e tri barazime. Edhe në përballjet direkte Barcelona ka gjashtë fitore, derisa PSG-ja ka katër fitore. Në fundjavë Barcelona në La Liga e mposhti Cadizin me rezultat 1-0, por gjasat për titull janë shumë të vogla në këtë edicion. Në anën tjetër PSG-ja është në rrugë të mirë për të fituar

një tjetër trofe në Ligën 1, por Liga e Kampionëve është trofeu që klubi dëshiron dhe shpreson që në këtë rrugëtim t'i japë ndihmë edhe ylli i skuadrës Kylian Mbappe, i cili në fund të edicionit mund të transferohet në Real Madrid. Për këtë ndeshje Xavi do ta ketë mungesën e Gavit dhe Alejandro Balde që janë të lënduar si dhe Christensen e Sergi Roberto për shkak të kartonëve të verdhë. Në anën tjetër Luis Enrique nuk do t'i ketë në dispozicion Presnel Kimpemben, Layvin Kurzawa dhe Sergio Ricon, derisa në dyshim është Nordi Mukiele. Në ndeshjen tjetër do të përballen Borussia Dortmundi dhe Atletico Madridi. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Spanjë, Atletico arriti të fitojë me rezultat 2-1.



FORMACIONET MUNDSHME:

Barcelona: Ter Stegen; Kounde, Araujo, Cubarsi, Cancelo; Pedri, Gundogan, F de Jong; Yamal, Lewandowski, Raphinha.

Paris Saint-Germain: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Beraldo, Hernandez; Zaire-Emery, Ruiz, Vitinha; Dembele, Ramos, Mbappe.

Të martën takohen:	
21:00 Barcelona - PSG	(3-2)
21:00 Borussia Dortmund - Atletico Madrid	(1-2)

Koliqi pasi merr çmimin 'Ylli i javës': Synojmë titullin e kampionit



"Epoka e re"

PRISHTINË, 15 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 29 në Albi Mall Superligë i ka takuar portierit të FC Ballkani, Enea Koliqi. Vlerësimi i më të mirët të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Enes

Shosholli, Vllaznim Visoka dhe Selajdin Jerliu. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e 29 t'i jepet Enea Koliqit, pasi kur ishte rezultati 0-1 Enea kishte tri intervenime shumë të mira, duke mos lejuar të barazohet rezultati. Pasi mori këtë çmim futbollisti i FC Ballkanit u shpreh i lumtur që për herë të parë u vlerësua më i miri i javës. "Faleminderit për këtë çmim. Është një vlerësim i madh për mua. Dua t'ua

dedikoj të gjithë lojtarëve tanë që kanë pasur meritë për këtë fitore. Shpresojmë që të vijmë edhe çmime të tjera në të ardhmen. Objektivi i ekipit është i qartë - të jemi në vendin e parë në fund të kampionatit. Çdo ndeshje është si një finale për ne, veçanërisht në këto ndeshje të fundit, ku pikët janë të rëndësishme. Shpresojmë ta vazhdojmë këtë rrugë", ka thënë Koliqi për faqen zyrtare të FFK-së.

MKRS-ja shpall konkurs për projektimin e tri objekteve sportive

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shpallur tri konkurse projektimi për të ndërtuar tri objekte të rëndësishme sportive në vend. Sipas këtij konkursi të shpallur nga MKRS-ja, Suhareka dhe Rahoveci do të përfitojnë nga një stadium,

ndërsa komuna e Fushë-Kosovës do të përfitojë një palestër të gjimnastikës, kështu ka bërë me dije ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku.

"Kemi shpallur tri konkurse projektimi për tri objekte të rëndësishme sportive në vend.

Suhareka dhe Rahoveci do të bëhen me stadione të reja futbollit, ndërsa Fushë-Kosova me palestër të gjimnastikës. Të tria komunat tashmë i kanë përfunduar me sukses procedurat e ndarjes së lokacioneve. I ftojme studiut dhe arkitekturës që të bëhen

pjesë e këtyre konkurseve me projekte kreative e profesionale në shërbim të sportit e sportistëve tanë. Vazhdojmë pa humbur kohë në konsolidimin e infrastrukturës sportive dhe përgatitjen për mikpritjen e Lojërave Mesdhetare 2030", ka shkruar Çeku.



Guardiola: Do të luftojmë për ta fituar sërish tripletën

MANCHESTER, 15 PRILL - Pep Guardiola përshëndeti skuadrën e tij që është ende gjallë për një tjetër tripletë të mundshme dhe u ka bërë thirrje lojtarëve të tij që ta përqafojnë mundësinë e pabesueshme për të luftuar sërish në të gjitha frontet. City mposhti Lutonin 5-1 të

shtunën për ta marrë kryesimin e kampionatit për herë të parë që nga nëntori, ndërsa vëmendja tani është kthyer te ndeshja e kthimit çerekfinale e Ligës së Kampionëve kundër Realit të mërkurën përpara gjysmëfinale së Kupës FA kundër Chelseat. "Është e

pabesueshme të jesh sërish këtu. Çfarë privilegji. Pasi fituam atë që fituam sezonin e kaluar, ne jemi ende duke luftuar në Premierë Ligë me 21 pikë të mbetura. Të mërkurën do të luajmë kundër Realit, me një shans për t'u kualifikuar në gjysmëfinale me të gjithë energjinë që do të sjellin

tifozët tanë. Dhe në Kupën FA të shtunën e ardhshme kundër Chelseat luajmë sërish një gjysmëfinale. Ne do të përpiqemi ta zgjasim garën javë pas javë. Ne kemi një shans. Nuk e di çfarë do të bëjnë Liverpools me Arsenalin, por ne duhet t'i fitojmë ndeshjet tona dhe të



ushtrijmë presion mbi ta", ka thënë Guardiola.

Hamiltoni: Formula 1 nuk më bën të lumtur

LONDËR, 15 PRILL - Lewis Hamiltoni zbulon për herë të parë se bota e Formulës 1 nuk e bën të lumtur. Piloti shtatë herë kampion i Botës theksoi se i pëlqen të eksplorojë edhe në fusha të ndryshme që nuk lidhen me sportin, si një mënyrë për të qenë gati të nisë një jetë të re pasi të "pensionohet". Britaniku zbulon se ka mësuar shumë nga bisedat me legjenda të sportit si Michael Jordan, Serena Williams apo edhe Boris Becker. "Kur u futa për herë të parë në botën e Formulës 1 zbulova se gjithçka ishte zgjimi herët në mëngjes, stërvitja, vrap, vrap dhe vetëm vrap, asgjë më shumë. Nuk kishte vend për asgjë tjetër. Ajo që kuptova është se të punosh gjatë gjithë kohës nuk të sjellë lumturi dhe duhet të gesh një ekuilibër në jetë. Zbulova se isha mjaft i pakënaqur. Më mungonin shumë gjëra... sepse mendova: Jam në Formula 1, e kam realizuar ëndrrën dhe jam aty ku kam dashur gjithmonë të jem. Jam në krye. Po luftoj për kampionatin. Por, thjesht nuk ishte e këndshme. Ka shumë më tepër jashtë kësaj




bote dhe nuk kisha kohë për të eksploruar. Nëse shkoni në një zyrë çdo ditë dhe bëni të njëjtën gjë çdo ditë, thjesht do ta humbni kontaktin me botën e jashtme. Duhet të gjeni diçka tjetër që mund t'ju mbajë mendjen në lëvizje", ka thënë Hamiltoni. "Bisedova me shumë atletë të jashtëzakonshëm, nga Boris Becker te Serena Williams, madje edhe me Michael Jordan. Duke folur me të mëdhenjtë që kam takuar gjatë rrugës, të cilët janë në pension, ose ishin rrugës për t'u tërhequr,

kuptova se e kishin frikën për atë që do të ndodhte më pas. Shumë prej tyre më thanë se nuk kishin planifikuar asgjë për jetën pas sportit. Edhe unë kisha menduar gjithë jetën për Formula 1 dhe u ndjeva i përhumbur. Ishte një zbrazëti të cilën nuk e dija si mund ta mbushja. Kjo më bëri të mendoja shumë. Dhe, kështu u vendosa në kërkim të gjërave të tjera që kisha pasion. Unë nuk besoj te fjala 'nuk mundem'. Unë mendoj se për t'u bërë mjeshtër në diçka mjaftojnë 10 000 orë punë", u shpreh Hamiltoni.

Mbyllet sezoni i rregullt në NBA

OKLAHOMA, 15 PRILL - Ka përfunduar sezoni i rregullt i NBA-s, duke përcaktuar edhe renditjen përfundimtare të ekipeve pas 82 ndeshjeve. Vëmendja më e madhe ishte në Konferencën e Perëndimit, ku në vendin e parë e mbylli Oklahoma. Skuadra e Thunderit fitoi thellë



135-86 ndaj Dallasit, ndeshje ku për vendasit shënuan të 15 lojtarët e aktivizuar. Në vendin e dytë qëndron Denveri. Kampionët në fuqi fituan me rezultat 126-111 ndaj Memphisit, sfidë ku tetë lojtarë të Nuggetsit realizuan mbi 10 pikë. Rekordin më të mirë në NBA përgjatë sezonit të rregullt e ka Bostoni (64 fitore, 18 humbje), që fitoi me rezultat 132-122 ndaj

Washingtonit (Pritchard 38 pikë e 12 asistime). Fitoi edhe Miami, 118-103 ndaj Torontos, sfidë ku vendosi kolektiviteti i ekipit nga Florida. Fituan edhe lakersat, 124-108 ndaj New Orleansit, sfidë ku LeBron Jamesi realizoi një "triple double" (28 pikë, 11 rebounde, 17 asistime). Interesant fakti se këto dy skuadra do të përballen në "play-in" pas 48 orësh për të siguruar një vend në "play-off".

REZULTATET

Boston - Washington	132-122
Cleveland - Charlotte	110-120
Indiana - Atlanta	157-115
Miami - Toronto	118-103
New York - Chicago	120-119
Orlando - Milwaukee	113-88
Philadelphia - Brooklyn	107-86
Golden State - Utah Jazz	123-116
Clippers - Houston	105-116
Memphis - Denver	111-126
Minnesota - Phoenix	106-125
New Orleans - Lakers	108-124
Oklahoma - Dallas	135-86
Sacramento - Portland	121-82
San Antonio - Detroit	123-95

SHKURT

Bayerni në bisedime me Zidanen

Pasi Xabi Alonso konfirmoi se do të vazhdojë të jetë tekniku i Leverkusenit për sezonin e ardhshëm, Bayern Munchen filloi të kërkojë për një zgjedhje të re për ta pasuar Thomas Tuchelin. Sipas "Marca"-s, "bavarezët" kanë kontaktuar me Zinedine Zidanen, i cili ka qenë pa ekip për një kohë të gjatë. Zidane nuk ka drejtuar asnjë skuadër pasi përfundoi aventurën e tij me Real Madridin në vitin 2021. Bayern Muncheni ka kontaktuar me përfaqësuesit e trajnerit francez për të parë nëse ai është i interesuar për opsionin që po i ofrojnë. Në tre vitet që nga largimi i bankinës së Real Madridit, Zidane ka refuzuar disa oferta pune. Ai qëndroi te spanjollët nga viti 2016 deri më 2018 dhe nga 2019 deri më 2021. Ai ishte dy herë kampion i La Ligës, tri herë fitues i Ligës së Kampionëve dhe udhëhoqi ekipin në 11 tituj në total.

Unitedi kërkon 117 milionë euro, PSG-ja heq dorë nga Rashfordi

Marcus Rashford nuk ka pasur një formë të qëndrueshme këtë sezon me skuadrën e tij të Manchester Unitedit. Megjithatë, sulmuesi anglez është shumë i rëndësishëm për klubin dhe ata po mundohet me çdo kusht ta mbajë në "Old Trafford". Unitedi nuk është aspak i gatshëm të heqë dorë nga Rashfordi për ndonjë shifer të ulët gjatë merkatos së verës. Sipas "Mirror"-it, "Djajtë e Kuq" kanë vendosur një shifer prej 117 milionë eurosh për kartonin e sulmuesit anglez. Thuhet se PSG-ja ka hequr dorë nga interesimi për Rashfordin, pasi francezët ishin të gatshëm të paguanin rreth 75 milionë euro për të.

Klopp: Tash nuk kemi asgjë në dorën tonë

Liverpoolsi pësoi humbje të papritur në ndeshjen ndaj Crystal Palaces (0-1). Tash "Reds" ka dy pikë më pak se Manchester City që është kryesues në Premierë Ligë. Këtë humbje nuk e priti mirë Jurgen Kloppi, i cili ishte i sinqertë teksa theksoi se tashmë asgjë nuk është më në dorën e tyre. "Kemi humbur terren dhe natyrisht që tani nuk kemi asgjë në dorën tonë, por jam i bindur që nëse ne marrim maksimumin e pikëve, kundërshtarët do të ndalen. Edhe ata i pret një kalendar i ngjeshur dhe me shumë impenjime", u shpreh Kloppi.

Wirtz: Ende nuk më besohet që jemi kampionë

Bayer Leverkuseni e fitoi për herë të parë në histori titullin e kampionit në Bundesliga, por kjo e arritur historike ende duket se nuk është e vërtetë për talentin Florian Wirtz. "Emocion i papërshkrueshëm. Ende nuk e besoj dot se është e vërtetë. Gjëja e fundit që mendoj në këtë çast janë golat e mi. Suksesi i grupit vlen mbi të gjitha. Kemi përjetuar periudhë mahnitëse si në rezultate ashtu edhe në mbizotërimin e frymës. Ndonjëherë më dukej sikur titulli nuk do të bëhej kurrë yni pavarësisht se diferenca me ndjekësit thellohej. Megjithatë, pritja mbaroi dhe më në fund të gjithë kemi marrë atë që na takon. Kampionati gjerman nuk është aspak ligë e lehtë, mjafton t'i referohemi dominancës së Bayernit. Ne ia dolëm t'i mposhtim në fushë dhe me pikë. Shpresoj të zgjohem sa më shpejt nga kjo ëndërr", ka thënë Wirtz.

Arteta pas humbjes nga Aston Villa: Duhet të reagojmë ndaj Bayernit

Arsenali pësoi humbje nga Aston Villa dhe në këtë mënyrë vendin e parë e rrëmbeu Manchester City. Trajneri Mikel Arteta ndien keqardhje për rezultatin dhe veçanërisht për paraqitjen në

pjesën e dytë, ku skuadra e tij pësoi dy gola radhazi në fund të ndeshjes. "Dy paraqitje shumë të ndryshme. Pjesa e parë ishte e mrekullueshme, një nga pjesët më të mira që kemi luajtur

ndonjëherë kundër një ekipi të madh. Duhet të ketë pasur tre ose katër raste për gol ose më shumë. Nuk arritëm të shënonim dhe kjo u reflektua në pjesën e dytë. Ne nuk vazhduam me lojën e mirë

dhe pësua dy gola shumë, shumë të këqij", ka thënë Arteta. Spanjollit dëshiron të fokusohet vetëm në ndeshjen e radhës, tani që "Topçinjtë" nuk varen më vetëm nga vetja për t'u bërë

kampionë. "Ne kemi mundësinë më të mirë për të reaguuar ndaj Bayernit të mërkurën. Ekipi duhet ta tregojë. Nëse dëshiron të fitosh, duhet t'i kapërcësh këto situata", ka shtuar Arteta.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejepuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details

Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Isni Tahiraj nga Dashinoci KK Deçan, +37744162783 dhe 049/900-994. shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.i. "Zekiria Rexha" në Gjakovë kl. 1-8.
- Agon Reznici nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Q.A.O. në Gjakovë Instalues i Elektrikes.
- Naser Bordoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Faton Babuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "N. Nixha" Aotomekanik Gjakovë.
- Driton Bajram Halabaku shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit, drejtimi Juridik-Civil me nr. 895 të Universitetit "Hasan Prishtina" Prishtinë,
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

